



# UBT News

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

Gazetë e studentëve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji - Nëntor 2009

- UBT ndërton kampusin e ri universitar
- Rektori i UBT-së takoi kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha
- Zhvillimi ekonomik i vendit varet nga zhvillimi i sektorit privat
- Ndërlidhja e mekatronikës me menaxhmentin – çelës i zhvillimit të ndërmarrjeve moderne
- Anketë me studentët e UBT-së
- Bekim Gashi: UBT praktikon dhe promovon arsimim të lartë me standardet më të larta
- Fatbardha Qehaja: Sigurimi i cilësisë – një proces i pandalshëm në UBT
- Arton Celina: Rëndësia e Brendit në zhvillimin ndërmarrjes në Kosovë
- Valon Murtezaj: Sistemi global financiar dhe kriza

## UBT shpall konkursin për studimet Master



UBT shënoi fillimin e vitit akademik 2009/2010 me pritjen e organizuar për studentët e rinj

## Ecje e sigurt në rrugën e cilësisë dhe të suksesit

“Kompanitë publike po ashtu edhe private që janë më profitabile në vendin tonë menaxhohen nga studentët e UBT-së. Patjetër edhe ju do ta ndiqni rrugën e tyre, të karrierës së suksesshme, jetë të mirë dhe më të lehtë. Do të mundohemi bashkërisht me stafi tonë akademik në të ardhmen që ju të bëheni liderë dhe menaxherë të mirë të vendit”, u tha dr.Hajrizi studentëve të rinj

**1 tetor 2009. -**

UBT ka shënuar sot zyrtarisht fillimin e vitit të ri akademik 2009/2010, me një ceremoni ku ishin të pranishëm udhëheqësit e UBT-së, profesorët, studentët e rinj, si dhe familjarë të tyre.

Rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi, u ka dëshiruar mirëseardhje studentëve të rinj, duke shprehur bindjen se ata që nga dita e parë do

të angazhohen me intensitet të plotë për të nxënë dijet e reja, rrugë në të cilën UBT do t'i ndihmojë me të gjitha kapacitetet e tij.

“Kompanitë publike po ashtu edhe private që janë më profitabile në vendin tonë menaxhohen nga studentët e UBT-së. Patjetër edhe ju do ta ndiqni rrugën e tyre, të karrierës së suksesshme, jetë të mirë dhe më të lehtë. Do të mundohemi bashkërisht me stafi tonë akademik në të ardhmen që ju të bëheni liderë dhe menaxherë të mirë të vendit”, u tha dr.Hajrizi studentëve të rinj.

Më tej, dr.Hajrizi ka paraqitur para studen-



tëve një historik të punës së UBT-së, institucionit të arsimit të partë privat në vend, të akredituar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës, i cili në vazhdimësi ka këmbëngulur në ruajtjen me çdo kusht të cilësisë së studimeve.

Shkalla e qindpërqindtë e punësimit të të diplomuarve dhe pozitat e larta që ata kanë në institucionet dhe kompanitë ku punojnë pas studimeve të suksesshme në UBT tregojnë qartë se përcaktimi i UBT-së për studime të nivelit botëror ka dhënë rezultatet e veta dhe studentët e rinj do të ndjekin po këtë rrugë. Dr.Hajrizi ka përkujtuar se UBT-në e dallon

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së. Ky numër u përgatit nga: Naile Demiri dhe studentët: Saranda Musliu, Filloreta Hasani, Lirigzona Morina, Lum Gjickolli, Nora Hasani, Valëza Gela.

[www.ubt-uni.net](http://www.ubt-uni.net)

nga gjithë institucionet e tjera të arsimit të lartë bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet më prestigjioze në Evropë dhe në SHBA, përfshirë këtu ardhjen për ligjërime në UBT të profesorëve më në zë nga këto universitete, mundësinë e lëshimit të diplomave të dyfishta, vizitat studimore, si dhe mundësinë që studentët të UBT-së të vazhdojnë studimet në këto universitete.

Dr.Hajrizi gjithashtu ka përkujtuar se UBT është i anëtarësuar në shumë institucione ndërkombëtare, duke qenë në shumicën prej tyre përfaqësues i vetëm jo vetëm nga Kosova por edhe nga rajoni. Duke u nisur nga kjo, UBT edhe ka organizuar ngjarje me karakter ndërkombëtar, duke qenë në këtë fushë prijatë në rajon.

Ai gjithashtu ka përmendur se UBT organizon një varg aktivitete me karakter ndërkombëtar, përfshirë këtu një varg konferencash shkencore, të cilat mbledhin ekspertë nga të katër anët e globit.

Në këtë kontekst ai ka theksuar edhe bashkëpunimin e mirë që UBT ka biznesin kosovar, bashkëpunim që krijuar mundësinë për një varg iniciativash të përbashkëta në të mirë të studentëve dhe të biznesit.

Ndërsa, duke folur për infrastrukturën, dr.Hajrizi ka përmendur se UBT ka labora-

torë, që janë të veçantë në rajon, bibliotekën shumë të pasur me titujt më bashkëkohorë, ndërsa përkujtoi se studentët mund të gjejnë angazhim, përveç një varg aktivitete të tjera, edhe në botimet e UBT-së, në revistat periodike dhe shkencore që botohen në këtë institucion.

Në ceremoninë e pritjes së studentëve të rinj me një fjalë është paraqitur edhe dr. Bekim Gashi, profesor në UBT dhe koordinator për Shkenca Kompjuterike. Ai ka përkujtuar se për studime në këtë drejtim janë përcaktuar një numër i madh i studentëve të rinj, me të cilët do të punojnë një numër i madh profesorësh vendorë e ndërkombëtarë, ekspertë të kësaj fushe, ndërkohë që studentët do të kenë në dispozicion salla, kompjuterë dhe laboratorë për konkretizimin e punës së tyre.

Po kështu, si një faktor shumë pozitiv, ai përmendi edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me kompani të rëndësishme në vend, që do të mundësojnë zhvillimin në nivel sa më të mirë të punës praktike të studentëve.

Një fjalë rasti në këtë ceremoni, ndërlidhur me punën hulumtuese dhe studimore dhe rezultatet e arritura në këto fusha në UBT e ka mbajtur edhe MSc.Dipl.Ing.Binak Beqaj, bashkëdrejtues i Departamentit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT. ●





Në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit Tiranë-Prishtinë

## Rektori i UBT-së takoi kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha

Pasi kanë falënderuar kryeministrin Berisha për angazhimin e tij të vazhdueshëm për Kosovën dhe kanë shprehur dëshirën që z.Berisha të jetë anëtar nderi i AKB-së, anëtarët e delegacionit të bizneseve kosovare kanë kërkuar përmirësimin e mëtejme të shkëmbimeve tregtare mes Kosovës e Shqipërisë, duke e ngritur këtë në nivel më të lartë se shkëmbimet tregtare me vendet e treta, në mënyrë që shkëmbim gjithashtu të ngritë konkurrencën me vendet e treta

**Tiranë, 2 tetor.** - Rektori i UBT, prof.dr.Edmond Haxhizi ishte pjesë e një delegacioni të bizneseve kosovare që u takua me kryeministrin e Shqipërisë, dr.Sali Berisha. Delegacionin e bizneseve kosovare, të bashkuara në Aleancën Kosovare të Bizneseve (AKB), e kryesoi kryetari i këtij asociacioni, z. Agim Shahini, ndërsa në takim ishte i pranishëm edhe Ambasadori i Republikës së



Kosovës në Shqipëri, z.Gazmend Pula. Pasi kanë falënderuar kryeministrin Berisha për angazhimin e tij të vazhdueshëm për Kosovën dhe kanë shprehur dëshirën që z.Berisha të jetë anëtar nderi i AKB-së, anëtarët e delegacionit të bizneseve kosovare kanë kërkuar përmirësimin e mëtejme të shkëmbimeve tregtare mes Kosovës e Shqipërisë, duke e ngritur këtë në nivel më të lartë se shkëmbimet tregtare me vendet e treta, në mënyrë që shkëmbim gjithashtu të ngritë konkurrencën me vendet e treta. Ata kanë falënderuar gjithashtu kryeministrin Berisha për punën e madhe të bërë në infrastrukturën rrugore, sidomos me rrugën Durrës-Kukës, e cila u ka krijuar lehtësira shumë të mëdha bizneseve në të dy vendet dhe ka ndikuar shumë në shtimin e këmbimeve tregtare, me mundësi edhe të depër-

timit më të madh dhe shtrirjes së bizneseve në të dy shtetet.

Në takim është diskutuar edhe për shfrytëzimin e infrastrukturës së shtetit shqiptar për bizneset kosovare, si shfrytëzimi i porteve detare dhe infrastrukturës tjetër, shtimin e shkallës së investimeve të kompanive kosovare në Shqipëri, zhvillimin e forumeve ndërmjet bizneseve kosovare dhe atyre nga Shqipëria për të ngritur komunikimin dhe mundësinë e shpërndarjes së përvojave të mira ndërmjet veti, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore për teknikat dhe teknologjitë e rëndësishme, zhvillimin e projekteve me karakter publiko-private por edhe ato ndërkufitare, inkurajimin e bizneseve shqiptare për të marrë pjesë në karvanin e biznesit kosovar që mund organizohet edhe në relacionin Prishtinë-Tiranë e të tjera. ●

# UBT zgjeron bashkëpunimin me universitete në Britaninë e Madhe

**UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me një varg universitetesh prestigjioze në Evropë dhe në SHBA, në bazë të të cilave tash disa vjet është zhvilluar një bashkëpunim shumë i mirë, i cili ka dhënë rezultate shumë të mëdha, të cilat edhe e kanë bërë UBT-në një institucion të veçantë të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës**

Presidenti i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi ka qëndruar për një vizitë disaditëshe në Britani të Madhe. Gjatë kësaj vizite, z.Hajrizi ka vizituar një varg universitetesh dhe institucioneve të

tjera të arsimit të lartë, me të cilat UBT ka bashkëpunim, si dhe një numër të madh sish me të cilat gjatë takimeve u vunë bazat e bashkëpunimit të ndërsjellë. Në takime me drejtues të këtyre institucioneve, dr.Hajrizi i ka njoftuar ata lidhur me zhvillimet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, përfshirë zhvillimet politike, por edhe zhvillimet në sferën ekonomike, si dhe me theks të veçantë për zhvillimet në fushën e arsimit të lartë, ku, sidomos në sektorin privat, vendi ynë ka nevojë ende për mbledhje përvojash, por edhe mbështetje të vazhdueshme, në drejtim të arritjes së niveleve të edukimit të lartë në vendet e zhvilluara.

Dr.Hajrizi ka gjetur mirëkuptimin e



bashkëbiseduesve të tij për të shtrirë bashkëpunimin në një varg fushash. Si hap i parë i bashkëpunimit do të jetë angazhimi i profesorëve nga këto institucione për mësimdhënie dhe bartje përvojash në UBT, pastaj shkëmbimi i studentëve, organizimi i vizitave studimore e forma të tjera të bashkëpunimit. UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me një varg universitetesh prestigjioze në Evropë dhe në SHBA, në bazë të të cilave tash disa vjet është zhvilluar një bashkëpunim shumë i mirë, i cili ka dhënë rezultate shumë të mëdha, të cilat edhe e kanë bërë UBT-në një institucion të veçantë të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. ●

Bashkëpunimi ndërkombëtar

# Presidenti i UBT-së mori pjesë në mbledhjen vjetore të IPMA-së në Dablin

Në këtë takim Dr.Hajrizi ka paraqitur një pasqyrë të plotë të projekteve të zhvilluara në UBT si dhe ka bërë një rekapitullim të gjerë të zhvillimeve në

Republikën e Kosovës, në kuptimin e krijimit të legjislacionit dhe hapjes rrugë të iniciativave të reja në fushën e menaxhimit të projekteve, një fushë relativisht e re në vendin tonë

Presidenti i UBT-se, prof.dr.Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në mbledhjen vjetore të Këshillit të Përgjithshëm të Programit Ndërkombëtar për Menaxhim të Projekteve (IPMA), zhvilluar në Dablin të Irlandës.

Në këtë takim Dr.Hajrizi ka paraqitur një pasqyrë të plotë të projekteve të zhvilluara në UBT si dhe ka bërë një rekapitul-

publikime të ndryshme lidhur me menaxhimin e projekteve.

UBT është anëtar me të drejta të plotë në IPMA, i anëtarësuar me votat e shumicës së vendeve anëtare.

Edhe në mbledhjen në Dablin, përfaqësuesit e Serbisë kanë kundërshtuar anëtarësimin e Republikës së Kosovës përmes UBT-së në këtë institucion, si dhe kanë



lim të gjerë të zhvillimeve në Republikën e Kosovës, në kuptimin e krijimit të legjislacionit dhe hapjes rrugë të iniciativave të reja në fushën e menaxhimit të projekteve, një fushë relativisht e re në vendin tonë.

IPMA është organizatë prijëse botërore në fushën e Menaxhimit të Projekteve, e cila certifikon menaxherët e projekteve, krijon ekipe për menaxhimin e projekteve dhe hulumtues të suksesshëm, si dhe nxjerr

protestuat ndaj pjesëmarrjes së dr.Hajrizit në konferencë. Por, kjo situatë është tejkaluar pas reagimit të shumicës së anëtarëve të IPMA-së dhe të z.Hajrizi, i cili shpjegoi se Republika e Kosovës është shtet i pavarur dhe i anëtarësuar në shumë institucione ndërkombëtare, në shumë prej të cilave është pikërisht UBT që ka siguruar anëtarësimin dhe përfaqësimin e shtetit më të ri në botë. ●



## Bashkëpunimi i studentëve të UBT-së me kolegët e tyre në Japoni

# Studentët e UBT-së diskutojnë përmes një telekonference me kolegët e tyre në Japoni

Konferenca u organizua nga UBT në Prishtinë në bashkëpunim Univer-sitetit Bunkyo-Tokio, Japoni. Organizatorët e videokonferencës ishin Prof. Yuko Ikuta, nga Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Bunkyo Uni-versity dhe prof. Fatbardha Osmani në UBT dhe studentët e të dy univer-siteteve

**Prishtinë, 9 tetor**

**2009.** – Në vazhden e ngjarjeve dhe konferen-cave me karakter ndërkombëtar, të orga-nizuar në vazhdimësi nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë, ky universitet sot ka orga-nizuar dhe për herë të parë Videokonferencën ndërkombëtare me temën “Kompetencat ndërkulturore” .

Konferenca u orga-nizua nga UBT në Pr-ishtinë në bashkëpunim Univer-sitetit Bunkyo-Tokio, Japoni. Organiza-torët e videokonferencës ishin Prof. Yuko Ikuta, nga Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Bunkyo University dhe prof. Fatbardha Osmani në UBT dhe studentët e të dy universiteteve.

Fatbardha Osmani, ligjëruese në UBT dhe organizatore e videokonferencës, duke iu drejtuar pjesëmarrësve në sallë theksoi se kompetencat ndërkulturore të studentëve të UBT-së paraqesin cilësinë e këtyre studenteve të një horizonti shumë të pasur dhe të gjerë. Kjo gjithëherë duke u bazuar në faktin që një nder objektivat kryesore të UBT-së ka qenë dhe është ngritja e vlerave kulturore të studentëve në nivel ndërkombëtar. Ajo tha se konfer-



enca të këtij lloji do të vazhdojnë të jenë pjesë integrale e punës së stafit akademik të UBT-së, duke vazhduar me videokonferenca me universitetet partnere të UBT-së, universitetet e rajonit dhe më gjerë. Besiana Behluli dhe Rina Dizdari, studente në MBE në UBT, studimet në gjuhën angleze, prezantuan temën “Rishikimi i ngjarjeve historike dhe politike të Kosovës”. Në temë ato përmbledhën të gjitha ngjarjet më të rëndësishme gjatë dy dekadave të fundit, qysh nga viti 1989, kur situata politike në Kosovë ishte tensionuar më shumë, vitin 1998, luftën e fundit në Kosovë, përjetimet e popullit. Gjithashtu, dhe vitet e pasluftës në Kosovë, kohës në tranzicion, ndryshimet e mëdha që pasuan në jetën e përditshme,

dhe tani jetën pas pavarësisë së vendit, ku populli duhet të ballafaqohet me shumë sfida po ashtu dhe mundësi dhe dyer të reja që pavarësia i ofron.

“Pavarësia e Kosovës ka një kuptim të rëndësishëm për çdo qytetar: një mësues, student, bujk, president, etj. Ajo hapi dyer të reja dhe mundësitë për çdonjë prej tyre. Për ne si studentë, si dhe për gjeneratat tona, kjo do të thotë se ne mund të paraqesim vendin tonë në çdo ngjarje ndërkombëtare dhe të përpiqemi për të përfaqësuar atë me përgjegjësi më shumë dhe krenari. Kjo do të thotë shumë punë dhe sakrificë në rrugën tonë drejt BE-së. Kjo do të thotë shpresë për një të re dhe jetë më të mirë”, tha Rina Dizdari. “Ne duam të falënderojmë Japoninë për njohjen e Kosovës si një shtet të ri dhe të pavarur. Dhe ne shpresojmë se ne do të forcojmë marrëdhëniet tona, nëpër universitetet e tjera dhe duke punuar së bashku dhe do të vizitoj së shpejti vendin tuaj të bukur”.

Po ashtu Berat Thaçi, student i Fakultetit MBE ne UBT, bëri një prezantim që kishte të bënte me traditat, zakonet, kulturën dhe personalitetet e ndritura shqiptare. Ai para studentëve japonezë foli rreth Ilirëve si popull i lashtë në Ballkan dhe pasardhësve të tyre, shqip-

tarëve. Pastaj vazhdoi me traditat, vlerat dhe zakonet shqiptare, si besa dhe mikpritja. Gjithashtu paraqiti fotografi të veshjeve shqiptare, si plisi, të ushqimeve si flija dhe të instrumenteve muzikore tradicionale, si çiftelia e të tjera. “Plisi është një nga simbolet e identifikimit të meshkujve shqiptarë. Një prej simboleve më të rëndësishme kombëtare”, tha ai. Ai u ofroi atyre mundësinë të dëgjojnë edhe një këngë shqiptare. Në fund të prezantimit ai paraqiti personalitete të njohura shqiptare si nga e kaluar ashtu edhe nga e tashmja. Heroin kombëtar Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, Nënë Terezë, Ismail Kadarenë, Jim Belushin, Eliza Dushkun, Luan Krasniqin etj.

“Një grua shqiptare e lindur në Shkup, e cila e themeloi dhe u priu Misionareve të Bamirësisë në Calcuta të Indisë dhe për 45 vjet ka shërbyer për të varfëritë, të sëmurët dhe jetimët. Çmimit Nobel të Paqes -1979. Bekuar nga Papa Gjon Pauls 2 (2003) - "Tereza e Bekuar Calcuta", përfundoi B.Thaçi.

“Është e vërtetë që ne jemi pjesë e një universiteti ndërkombëtar, i cili na ofron kushte mjaft moderne dhe standarde, por qëllimi ynë ishte që t'i cekim gjithashtu përparësitë dhe mangësitë që universitetet aktuale ofrojnë”, thanë Ylberina

Gashi dhe Elza Zhavelli në paraqitjen e temës së përbashkët “Jeta studentore në Kosovë” “Kemi hapësira të bukura natyrore, vende argëtuese për t'u relaksuar gjithashtu edhe jeta e natës nuk mungon”, thanë ato dhe me pak fjalë bënë një përmbledhje të gjeneralizuar për jetën studentore dhe mundësitë që ofrohen për studentët.

Studentet te cilët u prezantuan ne ketë konference u vlerësuan për një nivel të lartë të gjuhës angleze dhe për një qasje shumë të mirë metodologjike për të treguar vlerat kulturore të shtetit tonë.





Bashkëpunim i mirë i IEME-UBT me MTI-në

## Përmbillet me sukses Programi “Internship Biznesi”

**Gjatë këtij programi studentët kanë punuar një muaj me stafin e biznesit, duke ndihmuar ata që të përmbushin objektivat e tyre me ç’rast sot gjatë përmbylljes së suksesshme të programit 200 studentëve iu ndan certifikatat e pjesëmarrjes në Internship Biznesin**

**Prishtinë, 23 tetor.** - Me rastin e përmbylljes së suksesshme të “Internship Biznesit”, Agjencia për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme pranë MTI-së dhe Instituti për Menaxhim dhe Inxhiniering të Ndërmarrjes (IEME) pranë UBT-së i ka pajisur me certifikata 200 studentë pjesëmarrës të këtij programi.

Gjatë këtij programi studentët kanë punuar një muaj me stafin e biznesit, duke ndihmuar ata që të përmbushin objektivat e tyre me ç’rast sot gjatë përmbylljes së suksesshme të programit 200 studentëve iu ndan certifikatat e pjesëmarrjes në Internship Biznesin.

Këshilltari i ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Nehat Ramadani, tha se në internshipin e parë ishin të përfshirë 50 studentë, ndërsa në këtë vit 200 që sipas tij me këtë po dëshmohej se programi Internship po u mundëson studentëve që njohuritë të cilat i kanë mësuar në teori, t’i aplikojnë në praktikë.

“Uroj Agjencinë për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, kompanitë dhe akterët e tjerë të përfshirë në këtë projekt në përpjekje të vazhdueshme që po bëhen me qëllim të nxitjes së ndërmarrjes. Agjencia për mbështetjen e NVM-ve përmes programeve konkrete vazhdon të kenë një qasje pragmatike dhe kreative, duke mundësuar të hapë perspektivë për të gjitha kategoritë e shoqërisë dhe në mënyrë të veçantë për brezin e ri e cila këtë vit për herë të dytë ka vazhduar me implementimin e projektit të “Internship Biznesi”, por kësaj radhe më ndryshe dhe me një numër më të madh ashtu siç kishte premtuar më parë”, tha ai.

Zbatues i projektit “Internship Biznesi” është Instituti për Menaxhim dhe Inxhiniering të Ndërmarrjes (IEME). Udhëheqësi i tij, rektori

i UBT-së, Edmond Hajrizi para të pranishmëve tha “jemi ne vazhden e punës që lidhen me edukimin dhe zhvillimin e bizneseve dhe kam pas nder ta përcjelli dhe ta koordino projektin “Internship Biznesi” tha rektori Hajrizi dhe më tutje foli për ecurinë e projektit “Si projekt ka filluar ndarja e studentëve në për kompani, përcjellja e tyre, nënshkrimet trepalëshe - studentë, kompani dhe MTI.

Janë përfshirë 49 kompani, në aspektin territorial 60 vende, PTK nuk ka qenë vetëm në Prishtinë por edhe në për qytete të tjera.

Prandaj kjo ka mundësuar të jetë një projekt i mirëfilltë, kanë qenë 92 femra dhe 75 meshkuj, vendbanimi i studentëve ka qenë nga të rrethë Kosova dhe ka pasur edhe nga vendet e regjionit si Maqedonia. Ka pasur prej fushave të ndryshme si fushës së ekonomisë, juridikut matematikë, arkitekturë, telekomunikacion etj. Shumica e fushave janë përfshirë në kuadër të këtij projekti. Procesi ka shkuar mirë, ka qenë i suksesshëm, studentët kanë përfituar shumë nga kjo praktikë, disa prej tyre janë ka i vazhdojnë kontaktet me kompanitë për mundësinë e punësimit në pune të rregullt. Studenti ka fituar edhe disa kredi për provimin”, tha rektori Hajrizi.

Rektori i Universitetit të Prishtinës, Mujë Rugova, ka vlerësuar të rëndësishëm programin “Internship biznesi”, duke thënë se ai krijon ura bashkëpunimi midis universitetit publik të Prishtinës dhe private dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

“Projekti të cilin ju sot e përmbillet “Internship Biznesi”, nxjerr në pah atë që na pret në vazhdimësi dhe vë baza të mira për rrugën që duhet ndjekur studentët dhe pedagogët e të gjitha universiteteve, pa marrë parasysh a janë ato shtetërore, a është ai universiteti

publik apo universiteti privat. Lidhshmëria, e cila krijohet midis universitetit, tash flas për universitetin publik dhe biznesit, është baza e së ardhmes, baza e zhvillimit të këtij vendi me që kjo formë e punës dhe kjo formë e veprimit në ngritjen e cilësisë së mësimi në botën perëndimore ka dhënë rezultate, të cilat e kanë çuar e çojnë dhe do ta çojnë përpara secilin vend që punon me këtë parim”, tha ai.

Njëra nga kompanitë pjesëmarrëse në këtë program ishte edhe Postë-Telekomi i Kosovës, e cila nga ky program ka pranuar 44 studentë, të cilët do të praktikojnë punën e tyre në PTK.

Kryeshefi ekzekutiv i PTK-së, Shyqyri Haxha, me këtë rast tha se është një sukses i madh kur një institucion apo universitet arrin të punësojë studentë të cilët kryen fakultetin nga ai institucion dhe sipas tij kjo mund të arrihet vetëm përmes programeve të tilla.

“Ne si PTK- kemi ofruar 44 vende pune apo praktikë të studentëve, të cilët do ta kryejnë praktikën në kompaninë tonë, nëse ata studentë vërtet tregohen të nevojshëm për kompaninë kompania domosdo duhet t’i punësojë, sepse varet prej tyre. Ne kemi nevojë për ekspertë , ju e dini mirë që shpesh ekspertiza kushton miliona”, tha Haxha.

Ai me këtë rast ka njoftuar të gjithë studentët se së shpejti PTK-ja do të dalë me bursa për studentë si kompani profitabile me qëllim të ngritjes së standardit të edukimit dhe ekspertizës.

Programi “Internship Biznesi”, ka për qëllim ndërtimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe bizneseve, të cilat operojnë në Kosovë me qëllim që të krijohet një produktivitet më i mirë në krijimin e mundësive për studentët gjatë kohës së studimeve njohurive të fituara të mund t’i zbatojnë në praktikë.

## Dy ligjërues të UBT-së qëndruan katër javë në Akademinë Diplomatike të Vjenës

Anëtarët e stafit akademik të UBT-së, Murtezaj e Hasanaj, gjatë këtij kursi intensiv katërfavor, shfrytëzuan mundësinë e jashtëzakonshme për aftësimin dhe avancimin e metejmë të njohurive si në gjuhën gjermane po ashtu edhe në çështjet politike, ekonomike, kulturore dhe historike për Evropën dhe Austrinë në veçanti, dhe për më tepër vizituan dhe morën pjesë në evenimente të rëndësishme kulturore jashtë Vjenës

Valon Murtezaj dhe Istref Hasanaj, ligjërues në UBT, morën pjesë në kursin intensiv veror për “Gjuhë gjermane dhe studime austriake” në Akademinë Diplomatike të Vjenës.

Pjesëmarrja e tyre u mundësua përmes bashkëpunimit dhe partneritetit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji dhe Akademisë Diplomatike të Vjenës.

Anëtarët e stafit akademik të UBT-së, Murtezaj e Hasanaj, gjatë këtij kursi intensiv katërfavor, shfrytëzuan mundësinë e jashtëzakonshme për aftësimin dhe avancimin e metejmë të njohurive si në gjuhën gjermane po ashtu edhe në çësht-

jet politike, ekonomike, kulturore dhe historike për Evropën dhe Austrinë në veçanti, dhe për më tepër vizituan dhe morën pjesë në evenimente të rëndësishme kulturore jashtë Vjenës.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, z.

Murtezaj dhe z. Hasanaj u angazhuan në një varg debatesh për tema të ndryshme dhe në veçanti për temat që kishin të bënin me Ballkanin dhe rolin e Kosovës në rajon, të organizuara nga Akademia Diplomatike e Vjenës, ku ata kontribuan me diskutimet dhe ofrimin e pikëpamjeve për çështje të ndryshme të marrëdhënieve ndërkombëtare.

U organizua konferenca “Zhvillimi ekonomik i Kosovës, e kaluara e tashmja dhe e ardhmja”

## Zhvillimi ekonomik i vendit varet nga zhvillimi i sektorit privat

Dr. Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së, ka thënë se zhvillimi ekonomik i vendit varet edhe prej zhvillimit të sektorit privat dhe bizneseve, duke filluar prej ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe deri ato të mëdhatë. Zhvillimi i tyre varet prej shumë faktorëve, menaxhimit, planifikimit afarist, gjetjes së tregut, etj., mirëpo nevojitet edhe ndihma nga ana e shtetit, përmes infrastrukturës ligjore favorizuese, politikave fiskale dhe kreditimit me norma tejet të vogla të interesit

**Prishtinë, 4 nëntor.** - Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), në ambientet e Hotelit Grand në Prishtinë, kanë organizuar Konferencën me temë “Zhvillimi ekonomik i Kosovës, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja”, ku përfaqësues të bizneseve dhe të institucioneve qeveritare dhe

joqeveritare, kanë zhvilluar një debat të gjerë rreth zhvillimit ekonomik, por edhe rreth zhvillimit të bizneseve dhe vështirësive të tyre me të cilat ballafaqohen ato sot.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini ka thënë se zhvillimi ekonomik në vend ka qenë një sfidë në të kaluarën, por edhe aktualisht

zhvillimi ekonomik është në një gjendje jo të lakmueshme, kur merren parasysh parametrat e zhvillimit. Megjithatë, përkundër vështirësive, krizës ekonomike globale dhe sfidave të ndryshme, bizneset kanë arritur që të mbijetojnë, të prodhojnë ose të kryejnë shërbime dhe të krijojnë një afarizëm të suksesshëm. Shahini ka kërkuar nga të pranishmit që të kyçen në debat dhe të japin mendimet e tyre rreth zhvillimit ekonomik dhe ndër-





marrësisë në sektorin privat, përkatësisht zhvillimin e bizneseve, si dhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen bizneset dhe komuniteti i biznesit.

Dr. Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së, ka thënë se zhvillimi ekonomik i vendit varet edhe prej zhvillimit të sektorit privat dhe bizneseve, duke filluar prej ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe deri ato të mëdhatë. Zhvillimi i tyre varet prej shumë faktorëve, menaxhimit, planifikimit afarist, gjetjes së tregut, etj., mirëpo nevojitet edhe ndihma nga ana e shtetit, përmes infrastrukturës ligjore favorizuese, politikave fiskale dhe kreditimit me norma tejet të vogla të interesit. “Përmes një angazhimi permanent dhe një planifikimi të mirë e detaj, ekonomia mund të zhvillohet. Përmes zhvillimit të sektorit privat ne krijojmë ndikim në zhvillimin ekonomik. Pyetja është si ta bëjmë një plan strategjik, plan aksional dhe planet e tjera të zhvillimit”, ka thënë Dr. Hajrizi.

Ai ka shtuar se prej vlerave që ne i gjenëojmë, si në planifikim, menaxhim, qasjen e sistemit financiar, etj., bizneset mund të arrijnë rezultate dhe të kemi një ekonomi të zhvilluar.

”Nga parimet biznese që ne i quajmë rezultate, nga parimet e partneritetit dhe përvojat e bizneseve, mund të mësojë edhe vetë shteti dhe institucionet. Me një punë të përbashkët të të gjithëve dhe me një përkushtim, ne mund të krijojmë një vend të zhvilluar. Sigurisht se në vitet e ardhshme do të jemi më mirë se sa jemi tash”, ka thënë ndër të tjera Dr. Hajrizi. Petraq Milo, këshilltar i kryeministrit të Shqipërisë, ka thënë se zhvillimi ekonomik në Shqipëri, sipas ekspertëve, ka një shkallë të konkurrencës rajonale dhe evropiane. Sipas tij, duhet të ekzistojë mbështetja për zhvillimin e bizneseve, si dhe ndihma për to me kreditime favorizuese dhe politika nxitëse fiskale. Kapacitetet duhet të shfrytëzohen, kurse nga bizneset mund të marrim përvoja, ka thënë Milo.

Më tej ai ka shtuar se në Shqipëri vepron shumë biznese, të cilat nuk kanë licenca, por në anën tjetër nevojitet që të bëhen reforma të thella të biznesit, të futet teknologjia informative moderne, qasje në sistemin bankar, kurse prodhimet të eksportohen. Për të gjitha këto bizneset kërkojnë mbështetje, ka thënë Milo.

Milazim Abazi ka thënë se ne jemi vonuar me zhvillimin ekonomik. Sipas tij kjo ka ndodhur për shkak të dy gjërave, një ishte koha e Milosheviqit, kur e shkatërroi ekonominë kosovare, dhe dy pasojat e luftës shkatërrimtare. “Kosovës deri më tash i ka munguar një strategji e zhvillimit. Këtë edhe pas 10 viteve nuk e kemi. Ngjarja kyçe pas luftës ishte privatizimi, mirëpo themelimi i fondit të mirëbesimit ishte një gabim, sepse mjetet nga ky privatizim i NSH-ve u bllokuan jashtë vendit, njësoj sikurse edhe mjetet e Trustit”, ka thënë Abazi.

Sipas tij, një problem tjetër me të cilin ballafaqohet Kosova është shantazhimi i CEFTA-s dhe borxhet e jashtme, të cilat borxhe prej vitit '89 deri '99 duhet t'i paguajë Serbia.

Gani Gërguri ka folur për rolin e BQK-së, si një licencues dhe rregullator në tërë sistemin financiar dhe ndikimin që ka BQK-ja për ndihmën e zhvillimit të bizneseve, siç është dhënia e kredive, që sipas tij, ka arritur në mbi 1 miliardë e 72 euro, që fletë për mbështetjen e biznesit.

Naser Grajcevc, nga MTI-ja ka thënë se ka parametra jo të volitshëm ekonomik, ndërsa në zhvillimin e ndërmarrësisë ka probleme infrastrukturore, siç është energjia, etj.

“Edhe pas 10 viteve Kosova ende nuk ka strategji zhvillimore. Numri më i madh i bizneseve janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme. E kemi problem transportin, kurse prokurimi publik është me rëndësi. Papunësia nuk është si u tha 70 për qind, por 38-45 për qind. Kultura e ndërmarrësisë ende mungon, ka nivele të ndryshme, kurse edhe hulumtimi i tregjeve nuk

është i kënaqshëm”, ka thënë Grajcevi. Sokol Krasniqi, këshilltar në MTI ka thënë se ne duhet të hyjmë në ekonominë e tregut, kurse iniciativat e biznesit dhe ato qytetare, janë të mirëseardhura. “Sa i përket zhvillimit ekonomik, ne ende nuk kemi strategji zhvillimore. Edhe më tej mungon menaxhimi i mirë i projekteve. Ne duhet të bashkërendisim veprimtarinë zhvillimore në relacionin biznes-komuna”, ka thënë Krasniqi.

Ndërkaq, pronari i Fabrikës “Inter-Company”, Sylejman Konushevi, ka thënë se CEFTA po i sjell dëme ekonomisë vendore. “Sikur në vitin 2015 apo 2020 ta kishim CEFTA-n, për ne atëherë do të ishte mirë, ngase ne po jetojmë prej importit e jo prej eksportit, derisa vendet e tjera jetojnë prej eksportit. Ne prodhuesit më parë duhet ta mbushim tregun vendor, e më pas të eksportojmë. Vendet në regjion i marrin paratë tona (nga importi) dhe ne ua zhvillojmë ekonominë atyre”, ka thënë Konushevi. Sali Hoda nga Doganat e Kosovës, ka shpjeguar çështjet që kanë të bëjnë me doganat dhe importin apo edhe eksportin e mallrave. Sa i përket moszbatimit të CEFTA-s nga ana e disa vendeve në regjion, ai ka thënë se ky është problem politik. Gjatë këtij debate u tha se duhet të stimulohet prodhimi dhe të favorizohet eksporti. Kjo me qëllim të zhvillimit ekonomik të vendit.



Jeton Mahmutaj ka thënë se produktet duhet të jenë cilësore dhe të sigurta. Për këtë duhet të plotësohen standardet dhe të shikohet konformiteti i produkteve se a janë të sigurta.

Berat Mustafa, nga Fabrika e lëngjeve “Fluidi” ka thënë se prodhuesit vendorë po dëmtohen nga akciza e pijeve. Ibrahim Rexhepi, publicist dhe analist i ekonomisë, ka thënë se bizneset dhe produktet vendore duhet të mbështeten, kurse sa i përket shkeljes së CEFTA-s nga dy vendet në rajon, nuk më habit aq shumë, sepse dihet qëndrimi i tyre. Agim Shahini ka thënë në fund të konferencës se duhet të bëhet zbatimi i ligjeve dhe të ketë politika të qëlluara fiskale, sepse me këtë do të kemi një biznes të zhvilluar dhe një ekonomi më të mirë. Ai ka porositur konsumatorët që të konsumojnë prodhimet vendore. ●



**UBT organizoi konferencën ndërkombëtare “Ndërmarrja moderne: Menaxhimi, Inxhinieria dhe Kompjuterizimi”**

## **Ndërlidhja e mekatronikës me menaxhmentin – çelës i zhvillimit të ndërmarrjeve moderne**

**Zhvillimi i mekatronikës dhe ndërlidhja e saj sa më e madhe me pjesët menaxheriale, u shtrua nga referuesit si një çështje shumë e rëndësishme në periudhën e zhvillimit modern të teknologjisë**

**6 nëntor, 2009.** – Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë, në vazhdën e organizimit të konferencave me karakter ndërkombëtar, ka organizuar sot konferencën shkencore me temë “Ndërmarrja moderne: Menaxhimi, Inxhinieria dhe Kompjuterizimi”. Konferenca që mbledhi

ekspertë dhe profesorë të kësaj fushe nga institucionet ndërkombëtare, partnere të UBT-së, si dhe ekspertë vendorë të kësaj fushe, u organizua në partneritet nga UBT e Institute for Enterprise Management and Engineering (IEME), si dhe institucionet ndërkombëtare: Institutin për Pajisjet dhe Trajtimin e Robotikës (IHRT), Universiteti i Teknologjisë i Vjenës në Austri, Instituti për Teknologji (ËIT) në Irlandë dhe Universiteti Kazino në Itali,



me përkrahjen e projektit TEMPUS. Konferenca i zhvilloi punimet në tri sesione, në të cilat u prezantuan një varg të arriturash nga hulumtimet shkencore të pjesëmarrësve të konferencës. Zhvillimi i mekatronikës dhe ndërlidhja e saj sa më e madhe me pjesët menaxheriale, u shtrua nga referuesit si një çështje shumë e rëndësishme në periudhën e zhvillimit modern të teknologjisë. Në këtë vazhdë, u theksua si domosdoshmëri e kohës krijimi i një programi të ri



për bashkëpunim me kompanitë private, e cila përfshin një marrëveshje trepalëshe mes UBT-së, kompanive dhe studentëve. Në konferencë, e cila zgjoi interesimin e madh të studentëve të UBT-së dhe të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në vend, u bë fjalë edhe për projektin e krijimit të një roboti i cili do të ndihmojë njeriun në jetën e përditshme, një e arritur kjo e cila shënon nivelet shumë të larta të zhvillimit të shkencës.

Nisur nga fakti se në vendin tonë po shtohen gjithnjë e më shumë ndërmarrjet prodhuese, në konferencë u theksua përparësia e madhe që ofron mekatronika në krijimin e lehtësirave të mëdha në fushën e prodhimit, por edhe në rritjen e kualitetit të produkteve, një problem nga i cili edhe më tej vuajnë ndërmarrjet prodhuese kosovare.

Problemi i kualitetit të prodhimeve vendore u ndërlihd në konferencë edhe me nivelin e përgatitjes profesionale të kompanive të fushave të ndryshme në vend, të cilat kanë synim depërtimin edhe në tre-

gun ndërkombëtar. Me këtë rast, bazuar në hulumtimet e ndryshme u konstatua se ndërmarrjet kosovare, edhe nëse mposhtin barrierat e ndryshme të natyrave të tjera, e kanë problem të depërtojnë në tregun ndërkombëtar pa plotësuar kriteret e kërkuara me standarde ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit në konferencë, duke diskutuar zhvillimet e përgjithshme në vend, theksuan domosdoshmërinë e investimit gjithnjë e më të madh në ngritjen e kualitetit, në inkorporimin e standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe të menaxhimit, të arritura këto që mund të bëhen vetëm me studime në fushën e mekatronikës dhe teknologjisë në përgjithësi, me angazhimin e ekspertëve të njohur ndërkombëtarë e vendorë, si dhe me sjelljen në vend të përvojave më të përparuara botërore.

Krahas studimeve për Inxhinieri dhe Kompjuterizëm, UBT është institucioni i vetëm i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës që ofron studime edhe në fushën

e Mekatronikës, studime që janë akredituar nga ky vit akademik dhe të cilat kanë zgjuar interesimin e të rinjve dhe përfaqësuesve të bizneseve në vend. Konferenca “Ndërmarrja moderne: Menaxhimi, Inxhinieria dhe Kompjuterizimi” është konferenca e dytë shkencore ndërkombëtare e organizuar gjatë kësaj jave në UBT. ●



# UBT shpall konkursin për regjistrimin në studimet e nivelit Master

UBT ka nisur tash më shumë se një muaj vitin e ri akademik 2009/2010 për studimet Bachelor me programet e akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës.

Programet që ofron UBT, sikur edhe në vitet e tjera, edhe këtë vit kanë zgjuar interesimin e madh të studentëve të rinj, ndërkohë që partneriteti me institucione ndërkombëtare dhe ndërlidhja me ekonominë dhe industrinë në Kosovë i ka dhënë këtyre studimeve një peshë të veçantë.

Por, nuk janë atraktive dhe të kërkuara vetëm drejtimit në studimet Bachelor në UBT.

Siç e dini UBT veprimtarinë e vet akademike e ka filluar me programet Master, të cilat kanë rezultuar me krijimin e liderëve kosovarë në fushën e menaxhimit, teknologjisë, diplomacisë, integritimeve evropiane, prokurimit publik, planifikimit hapësinor, arkitekturës, etj. Qindra studentë kanë përfunduar studimet Master në UBT dhe ata tani udhëheqin biznese dhe institucione të suksesshme kosovare dhe ndërkombëtare. Në përfundim të procesit të akreditimit nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës,



Qeveria e Kosovës dhe MASHT-i kanë përmbyllur ciklin e akreditimit të programeve Master në institucionet private të arsimit të lartë.

Natyrisht UBT është akredituar dhe licencuar për të vazhduar traditën e suksesshme në ofrimin e programeve Master të nivelit ndërkombëtar.

Këto programe, si të gjitha programet e UBT-së, do të ofrohet në bashkëpunim me universitetet dhe institutet partnere ndërkombëtar, duke sjellë se bashku me ta programet më të reja të studimeve dhe profesorët e ekspertët më të njohur të lëmive përkatëse.

Kështu, sloganet e suksesit "Succeed with Quality" dhe "Top University for Top Students" vazhdojnë jetën e tyre.

**ZGJIDH MË TË MIRIN QË TË BËHESH MË I MIRI!**



# UBT ndërton kampusin e ri universitar

**Në saje të bashkëpunimit me komunën e Lipjanit UBT ndërton kampusin e ri universitar Kryetari i komunës së Lipjanit, Shukri Buja dhe rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi kanë zyrtarizuar marrëveshjen për ndarjen e truallit për ndërtimin e kampusit të ri universitar të UBT-së, në hapësirën në afërsi të QMI-së**

Në Kuvendin Komunal të Lipjanit u organizua ceremonia e nënshkrimit të kontratës midis Kuvendit Komunal të Lipjanit dhe të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) për lokacion e ri, afër QMI-së, në të cilën do të ndërtohet kampusi i ri universitar i UBT-së.

Kontratën e nënshkruan rektori i UBT-së, Dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i Kuvendit Komunal të Lipjanit, zotëri Shukri Buja.

“Dr. Edmond Hajrizi është qytetar i komunës së Lipjanit, i cili na ka nderuar me investimin e tij në komunën tonë, me ndërtimin e objektit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji”, tha i pari komuës së Lipjanit, z.Buja. Ai më tej shtoi se komunën e Lipjanit e sheh si një qytetëz me perspektivë në të gjitha lëmitë dhe pos të tjerash edhe qytet universitar.

“Pretendimet e mia kanë qenë ta bëjë një qytet universitar dhe sot po arrihet me nënshkrimin e kontratës me UBT-në”, tha z.Buja.

Ndërsa rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi ka falënderuar kryetarin Buja dhe komunën e Lipjanit për bashkëpunimin dhe mundësinë e ofruar UBT-së për zhvillimin dhe rritën e mëtejme të tij.

“Falënderoj kryetarin Buja për angazhimin, vizionin dhe mundësinë që i ka dhënë një universiteti siç është UBT, që të ketë një hapësirë shumë kualitative, një qendër në mes të bizneseve dhe industrisë, që nënkupton një qendër ndërkombëtare universitare dhe për transfer të teknologjisë, një qendër e cila do të krijojë mundësinë e edukimit dhe zhvillimit të bizneseve, teknologjisë por edhe prodhimitarisë”, tha dr.Hajrizi. Ai tha se kjo



ndërthurje

do të gjenerojë punësim dhe do të krijojë mundësi të reja për ndërmarrjet e Lipjanit po edhe të tërë Kosovës, sepse për neve është me rëndësi zhvillimi i përgjithshëm i Kosovës.

“Ne do të fillojmë menjëherë me ndërtimin.

Do të jetë një investim shumë i madh. Kur flas për UBT-në, dua t’ju them se ai ka bashkëpunim me rreth 40 universitete, institucione ndërkombëtare amerikane dhe evropiane, si dhe shumë kompani, që do të lidhen me ne, me juve dhe mendoj se aty do të bëhet një zhvillim i mirëfilltë dhe aty do të bëhet një qendër rajonale dhe jo vetëm kosovare. Unë mendoj që kryetari na ka dhënë një mundësi shumë të mirë që projektin ta realizojmë”, theksoi dr.Hajrizi, duke shtuar se lokacioni i ndarë nga komuna e Lipjanit, në afërsi të QMI-së, është një lokacion shumë i mirë dhe se investimet në të do të kapin vlera shumë të mëdha, për ta bërë atë sa më funksional dhe në shërbim sa më të mirë të studentëve, profesorëve, ekspertëve dhe komunitetit.



# Dr.Hajrizi: Standardet, një kriter shumë i rëndësishëm për bizneset kosovare

**19 nëntor.** - Presidenti i UBT, dr.Edmond Hajrizi, në cilësinë e udhëheqësit të asociacionit "Quality Kosova", ka marrë pjesë në pjesë në konferencën "Rëndësia e standardeve dhe implementimi i tyre", organizuar nga Agjencia e Kosovës për Standarde, që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Në një prezantim më të gjatë, dr.Hajrizi, që ishte edhe një nga drejtuesit e konferencës, ka paraqitur punën e deritashme të asociacionit "Quality Kosova", që paraqet një nga nismëtarët në fushën e standardeve në vendin tonë.

"Quality Kosova" është pranuar si anëtare e Organizatës Evropiane për Cilësi (European Organization for Quality), në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të kësaj organizate, mbajtur në Kiev të Ukrainës, anëtarësim ky që është cilësuar një sukses shumë i madh në përfaqësimin e Kosovës në institucione ndërkombëtare.

Organizatës Evropiane për Cilësi është vetëm një nga institucionet ku UBT e përfaqëson Republikën e Kosovës në institucione ndërkombëtare, duke qenë në shumë fusha nismëtare e ndërkombëtarizimit të Kosovës, me gjithë pengesat shumë të mëdha që i janë bërë këtij anëtarësimi dhe ndërkombëtarizimit në përgjithësi të institucioneve kosovare nga vendet që ende nuk e kanë njohur vendin tonë dhe të cilat kanë bërë shumë angazhime për të penguar depërtimin e institucioneve të vendit tonë edhe në organizmat ndërkombëtarë shkencorë.

Pranimi i "Quality Kosova" në organizatën që mbledh 35 shtete evropiane është gjithsesi një sukses shumë i madh, për faktin se Kosova për herë të parë përfaqësohet në këtë institucion me renome dhe më rëndësi të madhe ndërkombëtare.

Pas pranimit, Kosovës i mundësohet të marrë pjesë në shumë forume dhe organizata të tjera ndërkombëtare të cilësisë.

"Quality Kosova" funksionon që nga viti 2006



dhe është asociacion që merret me çështjen e kualitetit, standardeve, certifikimeve dhe konfirmimit. Ai promovon cilësinë në Kosovë, në bazë të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, merret me certifikimin e sistemeve e produkteve sipas standardeve ndërkombëtare, si ISO 9001 e të tjerë. Gjatë prezantimit të tij në konferencë, dr.Hajrizi ka elaboruar në detaje rolin dhe rëndësinë që kanë standardet evropiane dhe ndërkombëtare, disa prej të cilave në vendin tonë janë futur në zbatim pikërisht nga UBT. Ai gjithashtu ka theksuar se këto standarde kanë një rëndësi tepër të madhe për vetë bizneset e vendit, të cilat, duke zbatuar këto standarde jo vetëm që rrisin cilësinë dhe besueshmërinë tek partnerët dhe konsumatorët vendorë, por edhe bëhen biznese konkurruese në rajon dhe më gjerë.

Në konferencë ka folur edhe ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, Lutfi Zharku. Ai ka theksuar se Agjencia e Kosovës për Standarde është një institucion, i cili po zgjerohet dhe po bëhet më funksional në vazhdimësi. "MTI ka formuar shtyllat kyçe të kësaj infrastrukture. Është formuar dhe konsoliduar departamenti i metrologjisë, i cili po zgjerohet dhe po funksionalizohet vazhdimisht. Brenda dy-tri javësh do të jemi dëshmitarë të inaugurimit të laboratorit modern të metrologjisë legale në Kosovë, nën përkrahjen e fuqishme të Komisionit Evropian", tha ministri Zharku. ●

## Anketë me studentët e UBT-së

# UBT - një hap para të tjerëve, një mundësi e madhe për studentët

**Hana Janjeva**



Që nga hapja e Universitetit UBT kam qenë shumë kurioze të di diçka më shumë për të. Kam dëgjuar shumë fjalë të mira për këtë universitet si dhe për stafin

e tij. Sukseset e njëpasnjëshme të arriturat nga studentët e këtij universiteti më lanë mbresa edhe më shumë duke ndikuar tek unë të mendoj seriozisht se studimet e mija mund t'i përfundoja në UBT. Dhe në fund fati deshi që këtë vit universiteti im i preferuar të akreditohet dhe unë të jem pjesë e tij. Jam shumë e kënaqur dhe ndjem shumë mirë në mesin e kolektivit të tërë që mban në supet e veta ky universitet. Se ka një staf udhëheqës të shkëlqyeshëm ky universitet u pa në fillimet e tij. Secili nga personat që e përbëjnë këtë universitet e kryen punën e vet me shumë përgjegjësi dhe me shumë vullnet, ku me këtë rast është e pamundur që në fund mos të ketë rezultate pozitive. Duke filluar që nga profesorët, stafi administrativ etj., dhe në fund është e pamundur që edhe studentët të mos jenë të suksesshëm gjatë studimit si dhe pas diplomimit. Vetë fakti që më shumë se 90% e studentëve të diplomuar në Universitetin UBT kanë poste dhe punë të larta në institucionet apo organizatat të ndryshme shtetërore dhe private flet për seriozitetin e punës që bëhet në UBT.

Jemi shembull për të tjerët.

**Genta Brestovci**

Zgjedha UBT-në për studime, sepse i plotëson të gjitha kriteret e një universiteti evropian, është kolegji më i mirë në Kosovë. Ka partnerë të shumtë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët e bëjnë UBT-në një institucion modern dhe kjo ishte arsyeja që të filloj studimet në UBT. Kushtet të cilat i ofron UBT të japin një shtytje drejt një synimi të cilin e kemi ne studentët. Nuk besoj se ndonjëri nga ne mund të ketë ndonjë vërejtje për udhëheqësit, profesorët apo stafin administrativ të UBT-së. Deri tash ata kanë qenë në nivel të duhur për një universitet serioz dhe besoj se kështu do të jetë deri në fund të studimeve, po ashtu edhe studentët janë të mirë, të shoqërueshëm dhe kanë nivel të duhur edukativ.

**Njomza Prestreshi**



Arsyeja kryesore që më shtyri të studioj dhe që më impresionoi që në shikim të parë ishte pikërisht UBT, një kolegji privat modern, me një staf profes

sionist, me plan-program ndryshe nga universitetet e tjera, i cili ofron programe studimi sipas standardeve ndërkombëtare dhe mundësi për përvojë në punë. Ky kolegji mundëson edhe disa lehtësime për studime si pagesën

në formë këstesh dhe ne studentët mund të qëndrojmë brenda objektit, të shfrytëzojmë cilindo kabinet dhe bibliotekën që është e gatshme për çdo kërkesë nga ana jonë.

Fillimi i vitit të ri akademik mendoj se është një fillim i mbarë që e gjeti Kosovën më të zhvilluar në të gjitha sferat dhe puna e studentëve është më e përkushtuar për t'u bërë pjesë konkurruese e botës dhe vlerave shkencore e akademike.

Stafi është i mrekullueshëm, relacionet profesor-student janë jashtëzakonisht të mira ngase për çfarëdo lloj sqarimi apo moskuptimi nga ana jonë, mund të sqarohet shumë lehtë nga profesorët, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt apo edhe atë elektronike. Secili nga profesorët ka gatishmëri të jashtëzakonshme të kontribuojë në zhvillim dhe përparimin tonë.

### Flaka Jashari



Biznesi është fushë e rëndësishme jetike për ecjen përpara drejt përparimit dhe modernizmit si të individit ashtu dhe të shoqërisë.

Vendosa të studioj në

UBT pikërisht pasi ka drejtimin për biznes. Duke parë bagazhin ose njohuritë nga shkolla e mesme dhe fillimin e vitit të rri akademik, mendoj se do ngjitem një shkallë më lart në shkencën e biznesit. Kuptohet që viti i parë është hyrje në këtë shkencën e biznesit. Shkallët e tjera në ngjitje vijnë gradualisht. Fillimi ka qenë një gëzim por i mbushur me ankth. Po nisja një jetë të re. Jam studente në degën që më pëlqen. A ka më bukur? Kësaj ndjenje të bukur i shtohet horizonti i studimeve. Jemi dy palë “të

kundërta” me një qëllim të njëjtë, të fitojmë “betejën “ e shkollës, të marrë njohuri në degën që kam zgjedhur për studim, pra biznes. Kjo betejë në fushën e studimeve nuk fitohet pa udhëheqës, pa profesorët të cilët më duken të përgatitur. Sa për studentët, janë si unë, të etur për dije. Administrata na është gjendur e gatshme duke na kënaqur me shërbimin e vet.

### Herolind Dreshaj



Zgjodha pikërisht të studioj në UBT për arsye të shumta por po i cekim vetëm dy: kam dëgjuar nga gjeneratat e kaluara që ka një staf akademik të

shkëlqyer gjë që kanë dëshmuar me këto gjenerata dhe e dyta që ofron kushte të mira për studentët që të studiojnë në mënyrën më të mirë të mundshme. Për këtë edhe vendosa të vij këtu në UBT. Fillimi i vitit të ri akademik mendoj se është një fillim i mbarë si nga ana e studentëve ashtu edhe nga ana e profesorëve sepse falë angazhimeve të profesorëve dhe studentëve kemi krijuar një ambient të mirë për të studiuar dhe për t'i arritur synimet tona. Për një koleg siç është UBT-ja mendoj se fjalët nuk do të mjaftonin ta përshkruanin stafin, studentët dhe profesorët. Kjo do të thotë se të gjithë janë në nivelin e duhur, për këtë kemi dhe moton e UBT-së “TOP UNIVERSITY FOR TOP STUDENTS”.

### Veprim Mustafa

Kosova ka shumë institucione private, por zgjedhja dhe preferencat e mia definitive kanë qenë të studioj në UBT. UBT përmban një kualitet të studimeve me përvojë shumëvjeçare.





Në UBT takon njerëz të ndryshëm, me kultura të ndryshme nga anembanë bota. Jemi në drejtimin e Mekatronikës dhe shpresojmë që gjithçka do të

jetë në mënyrën më të mirë të mundshme. Profesorët në këtë departament kryesisht janë ndërkombëtarë të gjithë ekspertë dhe që sot janë duke menaxhuar teknikën më moderne në botë, kanë një përvojë shumëvjeçare dhe të gjithë kanë tituj akademikë. Mesazhi im është: “Bëhu pjesë e UBT-së që të kesh një të ardhme më të mirë dhe më të suksesshme”.

### Yllka Nelaj



Drejtimin që ka herë e kisha zgjedhur analizova të gjitha mundësitë dhe çka ofrojnë fakultetet në Prishtinë. Duke biseduar me kolegët dhe të afërmit e mi, dëgjova

vlerësime të larta për sistemin e ligjërimit dhe kushtet që ofron UBT-ja. Pasi që vizitova disa nga universitetet private dhe Universitetin e Prishtinës, zgjedhja ime përfundimtare ishte UBT-ja. UBT-ja ofron kushteve hapësinore të mrekullueshme (sallat e ligjërimit, kabinetet, biblioteka, salla për lexim, etj.) Tekstet të përpiluara me materiale të qarta si dhe literaturë tipike shkencore që mund ta shfrytëzojmë në bibliotekën tonë. Më pëlqen rregulli dhe disiplina që janë evidente si dhe organizimi i seminareve të ndryshme ku ne

studentët mësojmë dhe komunikojmë si të sillemi në mënyrë më bashkëkohore. Viti akademik filloi me kohë si ishte paraparë dhe ligjëratat zhvillohen sipas planprogramit të paraparë. Profesorët nuk mungojnë asnjëherë në ligjëratat, janë të rregullt dhe shumë aktivë gjatë orëve të ligjërimit. Orari i ligjëratave është shumë i përshtatshëm dhe respektohet si nga ligjëruesit ashtu edhe nga ne studentët. Orari është i përpiluar në atë mënyrë që na mundëson edhe të merremi me aktivitete të tjera. Dëshiroj t'i përmendi edhe kolegët e mi të cilët edhe pse vijnë nga viset e ndryshme të Kosovës por edhe jashtë saj, edhe pse është vetëm fillimi i vitit, raportet tona janë të mrekullueshme!

### Jeta Zenunaj



Arsyeja që më shtyri të studioj në UBT është se ishte ndryshe nga universitetet e tjera, ofronte programe bashkëkohore studimi sipas standardeve ndërkom-

bëtare, ishte partner me shumë universitete të njohura.

Mendoj se gjenerata ime ka një mundësi më shumë për të arritur qëllimet e veta.

Për vitin e ri akademik 2009/2010 mendoj që ka filluar mirë dhe besoj që do të vazhdojë kështu, të gjithë jemi të përkushtuar në studime nga të cilat presim rezultate të mira.

UBT -ja ka një staf të kualifikuar, të cilët janë të gatshëm të na shërbejnë në çdo moment. Në UBT ligjërojnë edhe profesorë ndërkombëtarë, gjë që e bën UBT dhe më cilësor.

**Naile Demiri**

Bisedë më dr.Bekim Gashin, ligjërues bashkëdrejtues i Departamentit të Shkencave Kompjuterike në UBT

## UBT praktikon dhe promovon arsimim të lartë me standardet më të larta

**UBT news: Z.Gashi, pse keni vendosur që ta vazhdoni karrierën tuaj në UBT?**


**Dr.Gashi:** UBT praktikon dhe promovon arsimim të lartë me standardet më të larta. UBT arrin këto standarde, duke ofruar programe studimi dhe syllabuse që janë duke u përdorur në vendet e tjera perëndimore evropiane që kanë traditë të gjatë në arsimin e lartë. Për më tepër UBT punëson profesorë që kanë shumë vite përvojë si në akademi dhe industri, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo do të thotë që studentët tanë kanë përparësi ndaj studentëve të tjerë në universitete të tjera për shkak se ata kanë mundësi të mësojnë dhe të ndërveprojnë me profesorët dhe personelin akademik me përvoja të tilla. Për më tepër studentët tanë kanë mundësi të kryejnë punë praktike në laboratorin e UBT, i cili është më i miri i këtij lloji në vend.

**UBT news: Cilat janë risi këtë vit në Departamentin e Shkencave Kompjuterike?**

**Dr.Gashi:** Në Departamentin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT ne ofrojmë programe studimi të shkëlqyer. Ne punojmë shumë ngushtë me profesorët tanë si në nivel kombëtar por edhe të nivelit ndërkombëtar, në mënyrë që të qëndrojmë në krye të zhvillimeve të reja shkencore dhe teknologjike. Ne arrijmë këtë duke bërë monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së studimeve duke marrë reagime si nga stafi ynë akademik por edhe studentët tanë.

**UBT news: Na tregoni diçka më shumë për mekatronikën?**

**Dr.Gashi:** Mekatronika është studimi i sistemeve mekanike që monitorohen duke përdorur komponente të duhura, të tilla si sensorët dhe të kontrolluara duke përdorur sisteme kontrolluese dhe sisteme kompjuerike. Sistemet Mekatronike janë gjithkund rreth nesh me aplikacione në çdo sektor të



Dr.Bekim Gashi

shoqërisë duke filluar nga fabrikat, automobilat, mikrovalë, aeroplanët, etj, prandaj studimi dhe njohuria e mekatronikës është jashtëzakonisht me rëndësi. Për më tepër trajnimi i brezave të ardhshëm të inxhinierëve, duke ju dhënë atyre aftësi gjithëpërfshirëse është jashtëzakonisht me rëndësi për industrinë e inxhinierisë në përgjithësi dhe për shoqërinë.

**UBT news: Cilat janë planet e zhvillimit të departamentit të Shkencave Kompjuterike në të ardhmen?**

**Dr.Gashi:** Ne kemi një plan afatgjatë në departament në lidhje me programet ekzistuese dhe programet e reja të specializuara për të ardhmen. Ne kemi një ekip profesionistësh në fusha të ndryshme të shkencave dhe inxhinierisë. Këta profesionistë punojnë ngushtë së bashku duke kryer takime të rregullta departamenteve në mënyrë që të identifikohen mangësitë e programeve në shtet dhe ne rajon.

Herolind Beqaj

## UBT dhe zhvillimi i arsimit të lartë modern

# Sigurimi i cilësisë – një proces i pandalshëm në UBT

**Kërkohet nga gjithë studentët e UBT të kuptojnë mirë rëndësinë e sigurimit të cilësisë në institucionin ku ata po studiojnë për të qenë gjithherë pjesë përbërëse e cilësisë në forma të ndryshme dhe me dëshirë e punë të palodhshme. Kjo nuk do të na ndihmojë të zhvillojmë vetëm UBT-në por edhe gjithë shtetin e Kosovës me vlerat më të larta në arsimin e lartë**

**Shkruan: Fatbardha Qehaja**



Globalizmi si fenomen i ri në botë ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm edhe në zhvillimin dhe në ndryshimin e sistemeve të edukimit në mbarë botën.

Dekada e fundit ka shënuar ndryshime drastike kur kemi të bëjmë me fushën e menaxhimit të edukimit, fushë kjo jo e zhvilluar shumë më parë. Për të arritur një funksionimin të menaxhimit adekuat të edukimit, domosdoshmërisht duhet të inkorporohet fryma e sigurimit dhe menaxhimit të cilësisë në institucion. Sigurimi i cilësisë si një organ i lokalizuar në institucion të arsimit të lartë ka bartur me vete shumë përgjegjësi por edhe sfida.

Në kuptimin e tij të ngushtë termi "sigurim i cilësisë" nënkupton krijim të cilësisë, mirëmbajtje dhe ruajtje të cilësisë, përmirësim si dhe zhvillim të cilësisë në një institucion. Të gjitha këto elemente shpjegojnë qartë se sa e rëndësishme është puna në cilësi dhe se sa e vështirë është ruajtja e cilësisë në një institucion. Kolegji UBT si hap prioritar, mu në fillim të krijimit të Zyrës për Sigurimin e Cilësisë ka përcaktuar qëllimin që në këtë institucion të krijohet domosdosh-

mërisht një KULTURË e cilësisë. Do të mund të shtrohej pyetja se a është kjo e mundshme të krijohet? Duhet theksuar këtu se kultura e cilësisë nuk mund të krijohet brenda një dite – siç është thënia në gjuhën angleze "gjërat nuk mund të ndërrohen brenda natës". Një rol sinjifikant në këtë punë luan edhe fakti që shoqëria e Kosovës ka pasur rastin të kalojë në fazën e ngrirjes së shkollimit zyrtar, e cila jo që nuk ka ofruar kualitet në edukim, por ka kthyer termin në kuptimin e saj më të shtrembër të mundur. Andaj është e kuptueshme që perceptimi për një krijim të kulturës merr kohë por që për të pasur sukses duhet të ndërtohet në vete dëshirën kolektive dhe vullnetin për të mësuar dhe për të zhvilluar metodologjinë e punës të çdonjërit në institucion.

Në punën e vet për të siguruar cilësinë, zyra për sigurimin e cilësisë në UBT, ka vendosur dy objektiva në këtë proces. Objektiva e parë është transparenca, përmes së cilës ZSC siguron që të gjithë akterët e UBT-së, qoftë stafi akademik por edhe studentët dhe bordi i industrisë informohen rregullisht dhe në mënyrë transparente për të rriturat dhe aktivitetet që krijojnë cilësinë. Për më tej transparenca sjell një faktor shumë me rëndësi, i cili është involvimi dhe pa të cilin sigurimi i cilësisë nuk mund të mbi-jetojë.

UBT ka përfshirë të gjithë përfaqësuesit e studentëve të të gjitha nivele në vendimmarrje si dhe ka involvuar për-



faqësuesit e bordit të industrisë dhe të stafit akademik. Ky organizim modern, i bazuar në standardet evropiane mbi sigurimin e cilësisë, është vlerësuar lart nga ekspert të akreditimit me rastin e vizitës së institucionit tonë. Një strukturim i tillë i strukturave vendimarrëse ka luajtur një rol tejet të rëndësishëm në procesin e vetëvlerësimit me ç'rast çdo vlerësim i punës tonë të brendshme është bërë nga studentët, stafi akademik si dhe bordi i industrisë. Përpos kësaj, qëllimi i dytë i UBT-së, respektivisht i zyrës për cilësi mbetet të jetë llogaridhënia si nga ana e stafit të brendshëm dhe të jashtëm akademik dhe administrativ po ashtu edhe nga ana e studentëve në arritjen e rezultateve më të larta të mundshme.

Për të shpjeguar më tej, krijimi i kulturës së cilësisë është një proces i pavdekshëm, është proces i cili vazhdon të jetë përherë në atë institucion përderisa ai institucion të jetë në funksion. E them këtë ngase është shumë e thjeshtë të kuptohet që në këtë proces institucioni nuk do të mund asnjëherë të

thotë që ja tani kemi cilësinë dhe projektin ka përfunduar. Qëllimi qëndron mu në të kundërtën, në momentin kur mendojmë se kemi arritur një kulturë atëherë konsiderojmë të kemi arritur në gjysmë të rrugës dhe se pjesa tjetër e mbetur është zhvillimi dhe përmirësimi i asaj që e kemi sot. Kjo filozofi e të kuptuarit drejt për krijimin dhe ruajtjen e cilësisë në UBT ka nevojë të ndjehet në të gjitha poret e institucionit tonë në çdo kohë, pa ndalur. Andaj kërkohet nga gjithë studentët e UBT të kuptojnë mirë rëndësinë e kësaj zyre e në veçanti të punës së sigurimit të cilësisë në institucionin ku ata po studiojnë për të qenë gjithëherë pjesë përbërëse e cilësisë në forma të ndryshme dhe me dëshirë e punë të palodhshme. Kjo nuk do të na ndihmojë të zhvillojmë vetëm UBT-në por edhe gjithë shtetin e Kosovës me vlerat më të larta në arsimin e lartë.

**(Autorja është mësimitdhënëse në UBT dhe udhëheqëse e Zyrës për Sigurimin e Cilësisë)** ●



Globalizimi dhe biznesi kosovar

# Rëndësia e Brendit në zhvillimin ndërmarrjes në Kosovë

Msc.Arton Celina, Fakulteti për Biznes dhe Ekonomi - UBT



## Abstrakt

Bota e biznesit është duke pësuar ndryshime pothuajse konstante. Gjenerata të reja të ndërmarrësve çdo moment paraqiten në skenën e biznesit me metodologji të reja dhe qasje moderne drejt depërtimit në tregjet e reja. Ndryshimet në ambientin e biznesit janë të drejtuara nga procesi i globalizimit, i cili ka shkrire pothuajse të gjithë kufijtë nacionalë, gjersa tregtia e lirë ka mundësuar integrimin ekonomik dhe industria e informacionit dhe revolucioni teknologjik ka mundësuar që gjeografia dhe koha të jenë jorelevante si pengesë në biznes. Për më tepër duke menduar për modelet e ndryshimit të botës së biznesit, mund të themi që kjo është një udhëtim e jo destinacion pasi që ndryshimi në biznes dhe ndryshimet e tjera përcjellëse do të jenë të përhershme në botën e revolucionit teknologjik.

Pa dyshim që globalizimi ka ndikuar në mënyrën se si ne jetojmë dhe si ne bëjmë biznes, por duket se ka ndikuar edhe në mënyrën si ne mendojmë dhe i qasemi përditshmërisë sonë.

Me këtë rast do ta kisha cituar shkencëtarin e madh, Albert Ajnshtajn me thënien e tij: "Pa e ndryshuar qasjen e të menduarit tonë nuk do të jetë e mundur zgjidhja e problemeve që i kemi krijuar me qasjen aktuale të të menduarit".

Kjo ishte thënia më adekuate që kam mundur ta gjej në hulumtimin bibliografik

për këtë çështje që vërteton nevojën për një qasje sistematike në adaptimin e ndryshimeve jo vetëm në sjelljet tona humane, por edhe në sistemin e të menduarit tonë.

Duke respektuar thënien, mendo globalisht dhe puno lokalisht, dëshiroj që të potoj me këtë rast se globalizimi pa dyshim që është prezent edhe në vendin tonë, dhe atë me të gjitha përmasat e tij. Për më shumë, në këtë vend ku jemi të ulur sot, sigurisht se tavolinat mund të jenë të importuara nga Turqia, karriget nga Kina, kompjuterët nga Japonia e shumë e shumë artikuj të tjerë nga vende të ndryshme të botës. Pra, mund të themi që të gjitha importet e mundshme janë të pranishme në shportën e konsumatorit kosovar dhe me këtë është krijuar një lloj konkurrencë midis produkteve të importuara dhe atyre vendore.

## Fuqia e Brendeve

Është interesant të thuhet se në lëmin e mikroekonomisë, tregjet më dominante për të cilat sot diskutohet është konkurrenca monopolistike, pra ky term edhe pse përmban dy terme kontradiktore konkurrencë dhe monopol, është terminologjia më adekuate për këtë lloj të tregut. Në fjalorin mikroekonomik, ky term është adekuat për tregjet ku:

1. Të gjitha kompanitë prodhojnë produkte të ngjashme por jo në mënyrë perfekte të zëvendësuar.
2. Të gjitha kompanitë janë në gjendje të hyjnë në të njëjtën industri nëse profitet mesatare që ofron industria janë atraktive
3. Të gjitha kompanitë janë maksimizuese të profitit.
4. Të gjitha kompanitë kanë një fuqi të caktuar në treg që do të thotë që asnjëra nuk është përcjellëse e dhunshme e

çmimit.

Pra këtu kemi te bëjmë me heshtjen e konkurrencës së brendeve, ku kompanitë konkurruese kanë shumë gjëra të ngjashme mes veti, por megjithatë janë të diferencuara në një mënyrë ose tjetër. Kur konkurueshmëria paraqitet si çështje diskutimi për kompanitë, idetë fillojnë të lundrojnë rreth përparësive konkurruese që një kompani mund të ketë ndaj një kompanie tjetër. Dhe kjo është mjaft me rëndësi për të bërë biznes realisht, por duke konsideruar heshtjen e përparësisë konkurruese dhe duke hulumtuar literaturat e ndryshme analizoja faktorët e suksesit në sigurimin e këtyre përparësive reale në treg.

Në mes të shumë faktorëve të përmendur dhe konsideruar si kruciale për sigurimin e suksesit në treg si: Produktet Inovative, Segmentimi i Tregut. Strategjia e qëlluar e marketingut etj, vëmendja ime u fokusua në fuqinë që i sjell brendi i reputabil një kompanie.

Për shumë njerëz, brendi asocion me emrin dhe logon e kompanisë apo të produktit të caktuar. Por, në realitet brendi ka domethënie shumë më të gjithanshme se vetëm kaq. Brendimi përfshin një proces të tërë për krijimin e një identiteti të mirëfilltë të kompanisë dhe kjo është e njëjtë për të gjitha kompanitë, si ato prodhuese ashtu edhe ato tregtare dhe shërbyese. Brendimi e orienton kompaninë si tërësi drejt një raporti aktiv dhe emocional me konsumatorin dhe kompanisë apo produktit. Në këtë aktivitet kompania me një brend të suksesshëm kujtohet nga konsumatori për çdo moment të shfrytëzimit të produkteve.

Kur tregjet bëhen më të konkurrueshme dhe konsumatorët bëhen më kërkues, kompanitë janë të detyruara të punojnë drejt një raporti afatgjatë me konsumatorët e tyre të cilët do të sigurojnë një rritje të qëndrueshme për kompaninë. Diferenca ndërmjet brendit mesatar dhe atij reputabil është në atë që brendi reputabil jo vetëm që do të okupojë imagjinatën e konsumatorit por ai do të jete prezent edhe

gjate zgjedhjes së produktit për konsum gjë që mundëson edhe ekspansionin e brendit në mënyrë kontinuele.

Ekzistojnë edhe diferenca të tjera në mes brendeve ordinere dhe atyre reputabile dhe ajo me e rëndësishme pikërisht qëndron në pagesën që konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë për produktin e tyre të preferuar. Përderisa brendet reputabile ndikojnë që konsumatori të paguajë çmimin e premiumit që paraqet edhe shpërblim për brendin e caktuar, brendet ordinere bazohen në një çmim të ulët për depërtim në tregje të caktuara.

Duke analizuar tutje brendet e mirënjohura botërore si Coca Cola, BMW, Harley Davidson etj., apo vetëm duke përmendur ato, të gjithë ne mendojmë për kualitet, mendojmë për produkte të verifikuara dhe të garantuara, për inovacionin që presim nga këto brende, në mënyrë të vazhdueshme, mendojmë për satisfaksionin që përjetojmë gjatë përdorimit të tyre dhe kështu me radhë.

Në po ashtu kemi pritje të ndryshme nga këto brende duke shpresuar të jemi të befashuar pozitivisht çdo herë që i përmendim dhe i shohim.

Ns anën tjetër shtrohet pyetja se çka ka speciale në ndërtimin e këtyre brendeve dhe sa kushton përkushtimi në ndërtimin e këtyre brendeve? Literaturat e shumta bibliografike sugjerojnë që brendi është pothuajse pasqyra e të gjitha sistemeve që operojnë brenda një kompanie, brendi po ashtu reflekton pasionin që ka kompania për tregun dhe konsumatorin, prezente në të është edhe lidhja emocionale ndërmjet kompanisë dhe ambientit eksternal që e rrethon, pra shumë gjëra objektive por edhe abstrakte që i japin vlerë biznesit të perditshëm.

Njeri nga burimet më të konsultuara në këtë çështje pa dyshim që është personi me kontribut të jashtëzakonshëm në këtë lëmi, i njohur për të gjithë ne z. Philip Kotler, i cili në njerin nga prezantimet e tij potencon rregullat e reja të marketingut në këtë epokë e që janë:

- Eksplorimi i tregtisë elektronike dhe biznesit elektronik.



- Ndërtimi dhe përdorimi i data bazës së konsumatorëve dhe portfolios së konsumatorëve.

- Fokusimi në jetëgjatësinë e raporteve me konsumatorin, vlerat që sjellin ato në biznes si dhe profitabilitetin e matshëm që vjen nga konsumatori.

- Zëvendësimi i promocionit të përgjithshëm me promocionin direkt.

- Ndërtimi i brendeve të reja sipas modeleve moderne.

- Bërja e biznesit elektronik dhe pa letra dhe burokraci.

- Partneriteti me punëtorët, konsumatorët, furnizuesit dhe distributorët.

Duke konsideruar elementet e lartpërmendura të involvuara në ndërtimin e brendeve të suksesshme dhe shumë elementeve tjera, do të kisha ritheksuar se revolucioni teknologjik dhe influenca e globalizimit kanë ndikuar që kompanitë të ndërrojnë paradigmat e menaxhmentit dhe të transformohen nga qasja e vëmendjes tek konsumatori dhe modeli i konsumatorit të kënaqur ne atë të konsumatorit të entuziazuar dhe modelit të sensit dhe reaktionit.

## Brendimi në Kosovë

Ambienti i përgjithshëm ekonomik në Kosovën e pasluftës është duke u përmirësuar dhe kaluar nëpër stadi të ndjeshme zhvillimore, ndërsa kompanitë në të gjithë sektorët janë munduar të sigurojnë vendin e tyre të merituar në tregun e caktuar. Tregu në Kosovë është i dominuar nga kompanitë e sektorit tregtar, të cilat kryesisht kanë importuar brende të njohura ndërkombëtare dhe biznesi i tyre ka vazhduar nën ombrellën e këtyre brendeve duke gjetur një pozicion të mirë imediat në treg të caktuar, por megjithëkëtë disa kompani tregtare kanë arritur që edhe nën këtë ombrellë të zhvillojnë brendet e veta. Kompanitë e sektorit prodhues kanë një histori më ndryshe pasi që ato kryesisht kultivojnë brende vetjake për të cilat ato kanë investuar nga pozita zero, e njëjta vlen edhe për sektorin e shërbimeve. Personalisht jam munduar që përmes një hu-

lumtimi të tregut të kuptoj më mirë se si kompanitë tona kanë kaluar nëpër fazat e rëndësishme të ndërtimit dhe promovimit të brendeve të tyre.

56 kompani janë të kontaktuara deri tani, nga të cilat 60% janë prodhues, 30% janë tregtare dhe 10% i takojnë sektorit të shërbimeve, dhe të gjitha kanë qarkullim vjetor nga 1-5 mil. € dhe kanë nga 5 – 100 punëtorë

Të gjeturat nga ky hulumtim ndryshojnë nga kompania në kompani dhe nga sektori në sektor, por ka edhe mjaft ngjashmëri ndërmjet kompanive të sektorëve të ndryshëm:

Do t'i cekim disa nga këto pasi koha këtu është mjaft e limituar dhe disa nga parametrat e këtij hulumtimi nuk janë ende të procesuara

- Një nga pikat me të rëndësishme që kam hasur ka qenë që shumica e kompanive prodhuese investimet në brende dhe programet promovionale të brendeve e konsiderojnë si investim ndërsa kompanitë tregtare si kosto

Kjo mund të jetë edhe ngase kompanitë tregtare, brendet e importuara nuk i konsiderojnë si pronë e tyre ndërsa ato prodhuese emocionalisht janë më të lidhura për to. Nga kjo shoh një risk potencial, sepse kur këto programe vështrohen si kosto atëherë zakonisht kompanitë marrin vendimet e tyre drejt minimizimit të koston, kështu që rezultatet në kultivimin e brendeve mund të jenë jo ato të dëshiruara, ndërsa tek ata që i konsiderojnë si investime vendimet merren varësisht nga alternativat më të mira.

- Shumica nga kompanitë përgjigjen se e kanë të qartë rëndësinë e brendeve në biznesin e tyre dhe se e kanë një plan konkret veprimi për zhvillimin strategjik të brendeve por këto plane janë kryesisht në formë të idesë por jo në formë të paraqitjes me shkrim,

- Të gjitha kompanitë thonë se zhvillimi i brendeve si koncept asociacion me marketing dhe reklamë,

- 11 kompani nga 56,9 prej të cilave prodhuese dhe 2 tregtare kanë staf që merret ekskluzivisht me marketing në hierarkinë

e tyre por asnjëri prej tyre asnjëherë nuk ka pasur kontrate me ndonjë agjenci konsultuese në këtë drejtim,

- Të gjitha kompanitë kane buxhetuar mjete për qëllime marketingu por pa e përmendur planin investiv për zhvillimin e brendit në atë buxhet,

- Të gjitha kompanitë janë të vetëdijshme për ndikimin e brendit në pozicionimin e kompanisë dhe produktit në treg por asnjëra nuk ka të përcaktuar buxhetin për Hulumtim dhe Zhvillim dhe për momentin asnjëri nuk është deklaruar se do të ketë për vitin që vjen,

- 15 nga 33 kompani prodhuese mendojnë se arsyeja pse konsumatorët blejnë produktet e tyre është çmimi i favorshëm që ata aplikojnë për produktet e tyre ndërsa të tjerët thonë që reputacioni i brendit dhe besimi që ai reflekton tek konsumatori është ai që shkakton blerjen.

- Me fjalën BRAND, 80% e kompanive të kontaktuara mendojnë se është fjala për Logo dhe emër të kompanisë përderisa të tjerët thonë se kjo nënkupton një koncept shumë më të gjerë se vetëm kaq. Vlerat e kompanisë, shërbimi që ajo ofron, kultura që kompania promovon janë disa nga elementet që janë përmendur si pjesë të këtij koncepti.

- 30% e kompanive të kontaktuara theksojnë se nuk kanë nevojë për brend sepse janë në biznes për më shumë se 10 vite dhe komunitetet si tregjet tona janë të vogla në strukturë kështu që nuk kanë nevojë për shumë investime në brende.

- Të gjitha kompanitë janë të vetëdijshme se brendet e njollosura ose reputacioni i mangët i kompanisë ka domethënie të bankrotit.

- 50% të kompanive prodhuese kane pasur eksperiencë eksporti në tregjet e jashtme por pjesa e shitjes nga eksporti nuk e ka kaluar 10% të shitjeve vjetore. Me këtë eksperiencë ata kanë pasur angazhime shumë të vogla apo të padukshme në zhvillimin e brendeve të tyre jashtë kufijve të Kosovës para se të eksportojnë.

## Konkluzioni

Mes gjetjeve të tjera në këtë hulumtim dhe këto të prezantuara më lart, shihet që kompanitë kosovare kanë bërë hapa të konsiderueshëm drejt vetëdijesimit të rëndësisë së brendit në biznes dhe se brendi nuk ka të bëjë me emrin dhe logon por me një koncept të përgjithshëm të zhvillimit. Është evidentuar po ashtu se rëndësia e brendit është në linjë me origjinën e produktit dhe kompanisë dhe se kompanitë prodhuese janë ato të cilave u takon investimi më i madh në kultivimin e brendeve përkatëse kultivim ky që do të jetë përcaktor i rëndësishëm i zhvillimeve të raporteve emocionale në mes të produktit, kompanisë dhe konsumatorit. Kompanitë tregtare, zhvillimin e brendeve e shikojnë më shumë nga prizmi i zhvillimit të konceptit të marketingut në përgjithësi. Duke konsideruar vështirësitë nëpër të cilat kompanitë kosovare kane kaluar në këtë periudhë të pasluftës në Kosovë, të natyrës së politikave ekonomike dhe politike, si dhe duke konsideruar madhësinë e kufizuar të tregut kosovar ku ato kryesisht operojnë, mund të konkludohet se kompanitë tona duhet të instalojnë në strukturat e tyre internale organizative një plan veprimi që do t'i drejtojë ato drejt promovimit të brendeve në nivel regional dhe më gjere dhe i cili do t'ju mundësojë atyre depërtimin në tregjet e jashtme duke atakuar mendjen e konsumatorëve të atjeshëm.

Për të arritur deri në këtë pikë kompanitë duhet të mbeten të fokusuar në investimet në kultivimin e brendeve, të jenë të hapura ndaj agjencive konsultuese, të jenë të përkushtuara në buxhetimin dhe aplikimin e hulumtimit dhe zhvillimit në planet e tyre zhvillimore dhe të gjitha këto do t'ju mundësojnë aplikimin e çmimit PREMIUM për produktet dhe zhvillimet e tyre.

*(Ky punim është paraqitur në konferencën “Zhvillimi ekonomik i Kosovës, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja”. Referencat janë hequr nga redaksia)*

Kriza botërore dhe efektet e saj

## Sistemi global financiar dhe kriza

**Ben Bernanke, udhëheqës i Rezervave Federale të Shteteve të Bashkuara, ditë më parë, deklaroi se recesioni më i keq që nga vitet 30-ta është pothuajse i kryer dhe ekonomia sipas gjasave është duke u rritur. Gjithashtu, edhe sipas parashikimeve të Komisionit European, eurozona do të kthehet në rritjen pozitive kah fundi i këtij viti, duke bërë që gjashtëmbëdhjetë vende të eurozonës të dalin nga recesioni**

Valon Murtezaj



Sot, mund të themi janë shenja të mira se gjendja e sistemit global financiar po fillon të këndellet.

Kjo është duke u konfirmuar edhe nga insti-

tucione të rëndësishme botërore. Ben Bernanke, udhëheqës i Rezervave Federale të Shteteve të Bashkuara, ditë më parë, deklaroi se recesioni më i keq që nga vitet 30-ta është pothuajse i kryer dhe ekonomia sipas gjasave është duke u rritur. Gjithashtu, edhe sipas parashikimeve të Komisionit European, eurozona do të kthehet në rritjen pozitive kah fundi i këtij viti, duke bërë që gjashtëmbëdhjetë vende të eurozonës të dalin nga recesioni.

Sidoqftë, shifra të larta të të papunëve kudo nëpër botë, do të vazhdojnë të persistojnë edhe për një kohë. Vetëm në Europë dhe Shtetet e Bashkuara, aktualisht shifra arrin në 30 milionë.

Ndërsa, sipas një raporti pjesë e të cilit ishte edhe nobelisti Joseph Stiglitz, në vitin 2009 numri i të papunëve në nivel global në krahasim me vitin 2007, mund të shkojë deri në 50 milionë.

Lidhur me tërë këtë, i kam vështruar

me vëmendje deklaratimet dhe punimet e shumë ekspertëve prominentë botërorë, nobelistë për ekonomi, mbajtës aktual apo të mëparshëm të pozitave të larta në administratën e Shteteve të Bashkuara, disa prej të cilëve kam pasur privilegjin t'i dëgjoj në ligjerata dhe të flas me ta lidhur me krizën globale financiare, dhe të gjithë në vizionin e tyre për të ardhmen e sistemit global financiar flasin për nevojën për reforma.

Të gjithë theksojnë rëndësinë e krijimit të një sistemi rregullator financiar më efektiv, zbatimin e qasjes globale në adresimin e situatës së krizës dhe evitimin e proteksionizmit, në radhë të parë nga ana e vendeve me ekonomi të fuqishme, si dhe rëndësinë e rolit të qeverive dhe politikanëve, në shtesë të rolit të ekonomistëve, në përpjekjet për daljen sa më të shpejtë nga kriza dhe recesioni, si dhe në krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi global financiar më të sigurtë në të ardhmen.

Gjatë pothuaj dy viteve të kaluara, kemi takuar sjellje të ndryshme lidhur me krizën globale financiare. Prej kërkesave për gjetjen e shkaktarëve të saj, deri te idetë për zëvendësimin e dollarit si monedhë e rezervës. Sipas nobelistit Michael Spence, kriza është përdorur dhe keqpërdorur, dhe do të vazhdojë të përdoret dhe keqpërdoret, por sidoqftë, ai thekson rolin e qev-



erisë në kohërat e krizës, që sipas tij është të pushojë së qenuri vetëm gjyqtar, por ajo, qeveria, duhet të fillojë të jetë lojtar dhe gjyqtar në të njëjtën kohë.

Profesori Solow tregon për rreziqet dhe thotë se ato shfaqen në ekonominë e përditshme apo reale, por ajo çka duhet të bëhet është të rialokohen ato, të zhvendosen tek ata të cilët janë më të përgaditur për t'i menaxhuar ato në mënyrë efektive.

Në këtë kuadër, një mendimtar tjetër prominent, nobelisti Paul Krugman thotë se ende ka arsye për t'u brengosur për rreziqet, por këto rreziqe janë politike, dhe jo ekonomike, pra sipas tij, ekonomia mundet ta tejkalojë borxhin e madh të shkaktuar. Ai bën një koment interesant duke thënë se deficitet e kanë shpëtuar botën duke shtruar një çështje se çfarë do të ndodhte sikur qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe partnerët e saj nëpër botë do të tentonin t'i balancojnë buxhetet e tyre, ashtu siç kanë bërë në vitet e 30-ta, gjë e cila sipas Krugman, shumë lehtë do të bënte të shihet përsëritja e depresionit të madh. Kur jemi te përsëritja e depresionit të madh, sipas Allen Sinai, President i Decision Economics, gjasat për përsëritje në janar të vitit 2009 ishin 25%, ndërsa në qershor ato kishin rënë në 10%. Sot, po flasim për tejkalim të krizës dhe dalje nga recesioni.

Daniel Price ish asistent për çështje të ekonomisë ndërkombëtare i presidentit George W. Bush, në një shkrim të tij për International Herald Tribune, duke tërhequr vëmendjen për nevojën për qasje globale ndaj krizës, thotë se nëse secili vend rregullon institucionet dhe prodhimet pa u kujdesur për impaktin në tregjet globale, atëherë një spirale e teposhtëzës do të rezultojë me siguri. Ngjashëm, Stiglitz tërheq vëmendjen se

duke u fokusuar vetëm në impaktet kombëtare, përkundër atyre globale, shtetet do të bëjnë që stimuluesi global të jetë më i vogël, dhe rimëkëmbja globale e dobësuar. Ndërkaq, Timothy Geithner, Sekretar i Thesarit dhe Lawrence Summers, Drejtor i Këshillit Ekonomik Kombëtar, kohë më parë siguruan për përcaktimin për qasje globale ndaj situatës, duke treguar përkushtimin për t'i udhëhequr përpjekjet për të përmirësuar rregullat dhe mbikqyrjen në tërë botën.

Një aspekt i rëndësishëm i reformave është theksuar në vazhdimësi mbikqyrja dhe rregullatorët. Duke folur për këtë, profesor Robert Westcott, ish këshilltar për ekonomi ndërkombëtare i presidentit Clinton, është optimist për rimëkëmbjen e ekonomisë, dhe thotë se nuk është çështja te krijimi i më shumë apo më pak rregullatorëve, por çështja është te vendosja e rregullave të mençura. Kjo është në fakt gjëja më e rëndësishme pasur parasysh se mbikqyrësit dhe rregullatorët duhet të jenë sytë që nuk mbyllen.

Në tërë këtë, përgjigja e administratës së Shteteve të Bashkuara po tregohet efektive. Presidenti Barack Obama e ka bërë të qartë kohë më parë se ajo çka është e nevojshme të bëhet në afatshkurtër është që të bëhet gjithçka që ekonomia e Shteteve të Bashkuara të lëviz, ndërsa në afatgjatë të fillohet të rivendoset diciplina fiskale dhe të zbuten deficitet.

Të gjitha këto, na bëjnë të besojmë se një klimë e mirëbesimit në publikun mund të pritët se do të krijohet, një aspekt i rëndësishëm ky në çfarëdo situatë krize apo postkrizë.

***(Ky shkrim është version i përpunuar i vështrimit të botuar më parë)*** ●

# The positive impact of UBT on my future studies!

Moreover using the motto of UBT, top education for top student, all the time makes to thing that this should be part of everyone hearts as top student and well organized for best future. It is daily issue that everybody wants to have the highest education. Finally all the above issues originate from my own opinion, but I hope that everybody has top education. In UBT everybody has the opportunity to be Top student with a brilliant future

Saranda Musliu



The influence of life occurs in our daily routine which evolves through our goals for our future achievement. Every human being in this world has a dream of becoming

someone or creating something on his/her own which reflects his or her status for the entire life. Although most of the skills and knowledge come from our education, it is very important that you get the right and superior education.

I have come to UBT from my previous years in a private secondary education in American School of Kosova.. I chose to come to this university considering the high level of professionalism of academic and administrative involved in this institution. Moreover what made me become even more interested and ambitious were the well distinguished study programs

based on the most advanced European and American university programs. The student climate remains the warmest part of my study journey in UBT which makes me feel happier every day to be a part of it.

On the other hand, it is worth mentioning that being part of a private university is a special privilege that not many students have in Kosova. There are many children in our country who are deprived of their right to education and the other ones who can't afford to enroll in private universities where the fees are quite high. But, I certainly believe that if there is a will there is hope too! I wish that one day all the youth in Kosovo will have a better and brighter future inside the country.

Moreover using the motto of UBT, top education for top student, all the time makes to thing that this should be part of everyone hearts as top student and well organized for best future. It is daily issue that everybody wants to have the highest education. Finally all the above issues originate from my own opinion, but I hope that everybody has top education. In UBT everybody has the opportunity to be Top student with a brilliant future.

‘Try to be innovative’

●

Të rinjtë dhe perspektiva

# Të rinjtë janë në udhëkryq të madh

**Rinia jonë pjesën më të madhe të kohës e kalon pa menduar se çka sjell e nesërmja. Një pjesë e tyre të motivuar nga familja e më pak nga shoqëria e gjejnë me lehtë rrugën drejt një të ardhmeje, po mjerisht shoqëria po bën fare pak për ta**

## Filloreta Hasani, studente në UBT

Është i lumtur populli që ka një rini siç është rinia jonë, është vlerësimi i parë për rininë tonë. Por, mjerisht, kjo nuk duket të jetë kështu.

Shoqëria jonë posaçërisht rinia në fazën e tranzicionit që po e kalon vërtet para vetes ka shumë sfida.

Edhe pse duket e motivuar për të qenë në trend me bashkëmoshatarët evropianë, si duket është ende larg. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë të arsimit të mesëm, orientimi jo i duhur profesional, mungesa e vendeve adekuate për të zhvilluar aktivitetet rinore janë pengesa shumë të mëdha për të ikur rinia jonë nga dukuritë devijante.

Mjerisht rinia jonë pjesën më të madhe të kohës e kalon pa menduar se çka sjell e nesërmja.

Një pjesë e tyre të motivuar nga familja

e më pak nga shoqëria e gjejnë me lehtë rrugën drejt një të ardhmeje, po mjerisht shoqëria po bën fare pak për ta.

Sot në Kosovë i riu ynë nuk ka perspektivë, nuk ka shpresa se një ditë do të bëhet i aftë për jetën e vet, familjen dhe shoqërinë.

I mungon pothuaj gjithçka. Nuk ka mjete për t'u shkolluar, nuk ka vend adekuat për t'u argëtuar etj.

Në Evropë i riu ynë është enëlarës, punëtor krahu ose roje e klubeve. Të pakët janë ata që kanë një punë te dinjitetshme.

Edhe në Kosovë pothuaj është e njëjta gjendje.

Ka shumë dukuri devijante posaçërisht nga të rinjtë. Që nga shkolla e mesme, përdorimi i narkotikëve, alkoolit, duhanit, armëmbajtja në shkolla, vjedhjet, konfliktet e pareshtura dhe dukuritë e tjera devijante janë një gjendje që kërkon që urgjentisht të mendohet për këto dukuri nga ata që janë të thirrur për të vënë rend e ligj.

Nëse vazhdohet me trendin e tillë të këtyre dukurive devijante një dite do të jemi shembulli më i keq për tërë rajonin.

Shpresojmë në vullnetin e mirë të miqve tanë që të na ndihmojnë për ta kaluar këtë fazë të tranzicionit.

E kjo arrihet me punë të pareshtur me rininë, duke vënë njerëzit adekuatë në vendet adekuate.





## Jeta studentore në Prishtinë

# UBT na ka hapur perspektivën e jetës

**Kryeqyteti ynë Prishtina është mjaft e përgatitur për jetën studentore në përgjithësi. Si student jemi mjaft të kënaqur me mundësitë që na i ofron si vend me vuajtje të shumta, me pavarësi të porsafituar. Që nga pas lufta mundësi të reja për student sa vijnë e shtohen. Jeta nga dita në ditë dhe teknologjia po zhvillohet çdo ditë e më shumë gjë e cila po u" a bënë jetën studentëve shumë më të lehtë**

### Lirigzona Morina

Shoqëria jonë kosovare në vazhdimësinë e formësimit të saj kombëtare dhe zhvillimit të saj institucional po has çdo ditë në sfida të reja. Që të vegjël ëndërrojmë të bëhemi dikush apo të merremi me diçka. Rritja është procesi që materializon ëndrrat në saje të një pune të pandërprerë, në të kundërt ato mbeten boshe, duke u shkelur nga këmbët e kohës.

Është shumë me rëndësi të luftosh për atë që do. Shumë prej nesh tani më si student jemi stabilizuar në vendet, ku e mendonim të luftonim për ëndrrat tona dhe t'i realizojmë ato.

Marrja e këtij vendimi shumicash prej nesh u ka bërë të shpenzojmë energji, pasi që është shumë me rëndësi se ku vendosim t'i realizojmë ato ëndrra. Jeta studentore nuk është e lehtë kurrë, mirëpo gjithmonë ti je ai që vendos se sa e lehtë dhe sa e ndërlikuar mund të jetë ajo në kohën dhe vendin e duhur.

Kryeqyteti ynë Prishtina është mjaft e përgatitur për jetën studentore në përgjithësi. Si student jemi mjaft të kënaqur me mundësitë që na i ofron si vend me vuajtje të shumta, me pavarësi të porsafituar. Që nga pas lufta mundësi të reja për student sa vijnë e shtohen. Jeta nga dita në ditë dhe teknologjia po zhvillohet çdo ditë e më shumë gjë e cila po u" a bënë jetën studentëve shumë më të lehtë.

Që të jesh më i miri duhet të zgjedhësh më të mirin. Fillimi i vitit të ri në universitetin UBT në krye me Dr.Edmond Ha-

jrizi ka bërë që të gjithë studentët të jenë mëse të kënaqur me zgjedhjen që kanë bërë, zgjedhjen drejt suksesit. Jemi shumë të kënaqur dhe krenarë të kemi të bëjmë me një kolektiv të kualitetit të lartë, të cilët punojnë pa pushim drejt suksesit dhe realizimit të qëllimeve tona, duke filluar nga kolektivi i profesorëve të cilët nuk hezitojnë t'i ndajnë me ne thesarin e njohurive të tyre, asistentëve që gjithmonë na dalin në ndihmë në rast kur kemi ndonjë paqartësi, mos te harroj te përmend edhe punëtorët te cilët gjithmonë kujdesen për ne dhe na ndihmojnë gjithashtu.

Nga kjo vatër dijeje kanë dalë emra të mëdhenj, të cilët kanë mbledhur njohuri dhe tani po korrin suksese nëpër botë. Ne jemi krenarë që një dite edhe ne pas përfundimit të studimeve do të kemi një karrierë të siguritë dhe plot suksese. Pasi që kjo është arsye pse ne zgjodhëm universitetin UBT suksesin e garantuar, vendin e stërmbushur me vlera. Është universiteti i cili po na e bën jetën shumë të lehtë dhe të mrekullueshme në çdo aspekt. Talenti është pikënisja për diçka, gjithmonë varet dhe është me rëndësi të zgjidhet vendi i duhur për të shpalosur atë talent. Kur ka vullnet të mirë gjithçka është e mundur. Kur mendojmë që mund të bëjmë diçka ne pothuajse kemi arritur të bëjmë diçka, të llogaritësh në sukses shpeshherë do të thonë të arrish vetë suksesin.

Për të gjithë ata që sapo kanë filluar vitin


e ri akademik, suksese dhe urime, sepse keni zgjedhur më të mirin... Për të gjithë ata që tashmë janë pjesë e tij dhe kanë bërë zgjedhjen e duhur, suksese të mëtutjeshme... Për kolektivin e mrekulueshëm dhe të palodhshëm, falënderim dhe respekt të veçantë, si dhe punë të

mbarë, kurse për të gjithë ata që ende nuk kanë vendosur se ku do t'i vazhdojnë studimet: zgjidhni më të mirin nëse dëshironi të jeni më i miri. UBT - vendi i vetëm i vetëm i përkryer i vlerave dhe kulturës drejt dijes, suksesit dhe karrierës. ●

### Dukuritë negative në shoqëri

## Shoqëritë që mbyllin sytë përpara dukurisë së drogës më vonë heqin pasojat e rënda të saj

**Nora Hasani, studente në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi**



Shoqëria moderne është nën presionin e madh të dukurive ose veprimeve të cilat janë të sanksionuara me normë dhe kur bëhen nga njerëzit, konsiderohen si e

keqe shoqërore.

Çfarë kuptohet me devijim? Nëse ndonjë njeri bën shkeljen e normave, të cilat janë të pranueshme dhe të mira për shumicën e anëtarëve të një shoqërie, atëherë bëhet fjalë për devijimin. Devijimi është problem kryesisht sociologjik, sepse identifikohet si rrezik për shumicën kur dikush bën veprë devijante.

Do të shohim disa nga këto që janë tash të pranishme edhe në Kosovë, me një trend të rritjes së vazhdueshme.

Kureshtja, pakënaqësia dhe revolta e të rinjve kundër rendit shoqëror apo sistemit të vlerave që dominojnë një shoqëri, pas-taj dëshira për t'u imponuar, pasiguria dhe mungesa e vetëbesimit, janë faktorët që konsiderohen më kryesorët pse droga është bërë pjesë e jetës në shoqërinë mod-

erne. Prodhimi dhe përdorimi i një pjese llojesh të drogave janë të ndaluara.

Nëse një i ri fillon të konsumojë drogën, atëherë ku qëndron arsyeja? Ka shumë arsye që i riu të bëhet pjesë e kontigjentit shfrytëzues të drogës. Hulumtimet kanë shtuar si burim të veprimit sociopatologjik të të rinjve edhe mungesa e kujdesit të duhur të prindërve, të cilët duke qenë të angazhuar me punët profesionale, udhëtimet dhe largimet e shpeshta nga familja, nuk janë të informuar për sjelljet e fëmijëve të tyre. Reagimet e prindërve të shumtën e herëve janë në stilin: "Fëmija im nuk përdor drogë, këtë e bëjnë disa djem apo vajza të tjera". Kuptimi i së vërtetës ata i sjell përpara dilemës, nëse fëmija i tyre dhe ata vetë si prindër, do të kuptohen drejt nga rrethi, kur të merret vesh për realitetin.

Hapja e temës për rrezikun që paraqet droga për të rinjtë, nxënësit veçmas tash po bëhet edhe pjesë e sistemit edukues dhe komunikues, social dhe arsimor. Shoqëritë që mbyllin sytë përpara dukurisë së drogës më vonë heqin pasojat e rënda të saj.

Forma më frytdhënëse për luftimin e përhapjes së drogës është arsimimi dhe veprimi preventiv. I riu po të mësojë drejt çfarë rreziku paraqet droga për shëndetin dhe të ardhmen e tij, e ka më lehtë të mos bëhet viktimë e saj. ●

Përimtime

# Tragjedia e Tisës dhe përgjegjësia e padefinuar

**Dita ditës po humbin krenarinë tonë, moralin dhe identitetin që e krijuam me shekuj të tërë, duke derdhur gjak. Kriza ekonomike, shkaktari që e gjithë kjo po ndodh mu në këtë kohë, e cila kërkon si kurdoherë më parë të jemi të bashkuar në krijimin e asaj, të cilën e deshëm dhe e synuam me dekada të tëra**

**Lum Gjikolli**



Fundin e tetorit dhe fillimin e nëntorit, tragjedia e Tisës ishte lajmi që më së shumti na trishtoi. Shumë kufoma, shumë lot nga e gjithë Kosova. A ishin ata personat që deshën një jetë më të mirë, të cilën nuk e gjetën në

mesin tonë. Dita ditës jeta në Kosovë është duke u bërë edhe më e vështirë.

Dita ditës po humbin krenarinë tonë, moralin dhe identitetin që e krijuam me shekuj të tërë, duke derdhur gjak. Kriza ekonomike, shkaktari që e gjithë kjo po ndodh mu në këtë kohë, e cila kërkon si kurdoherë më parë të jemi të bashkuar në krijimin e asaj, të cilën e deshëm dhe e synuam me dekada të tëra.

Jemi duke shpenzuar çdo ditë, kohë dhe para, për ligjet të cilat po vijnë me presion nga Perëndimi, duke mos krijuar vlerat tona. Duke i parë këto rrethana në të cilat ne jemi duke jetuar, mund ta gjejmë shumë lehtë fajtorin e gjithë kësaj.

Rrethanat në Kosovë janë interesante. Në vend që të kemi strategji politike për t'i mbajtur rininë dhe popullatën e Kosovës në Kosovë, ne shfrytëzojmë resurset tona për kampanja zgjedhore, të cilat janë gjithnjë e më të mërzitshme. Në një artikull të një profesori timin, të shumërespektuar, Prof. Valon Murtezaj, ishte e cituar kjo: "Shkollari i Kosovës është njeriu me zemrën e veshur me kostumet e bardha dhe të pastra të bëra nga stofi i thurur nga fijet e human-

itetit dhe të së vërtetës. Në çap që bën, jep çdo gjë për t'i shërbyer të mirës, ndjek dhe jetëson të vërtetën. Njëjtë, si Locke, mendon se është një e vërtetë e kundërt me mashtrimin, që mund të gjendet nëse njerëzit duan, dhe e kërkon atë. Njëjtë si Goethe kërkon më shumë dritë".

Por, sa është e realizueshme kjo, sa është e mundur që kjo të ndodhë, kur çdo ditë e më tepër po humbim si komb. Njeriu me zemrën e bardhë. Shumë fjalë e bukur për vesh. Gjatë gjithë këtij viti, ministria e jashtme nuk gjeti një strategji, se si ta integronte Kosovën në Bashkësinë Evropiane. Paraprakisht, ata preferuan indiferencën më shumë se zgjuarsinë. Pastaj, ata fajësojnë Evropën për mosintegrim të Kosovës në BE, duke mos fajësuar punën e tyre të dobët. Ne, në gjërat më të rëndësishme dhe kriteret për integrim në BE kemi dështuar, duke filluar nga media e lirë, gjyqësia dhe fuqia ligjore të jetë e ndarë nga politika, zhvillim normal ekonomik, një shërbim social të suksesshëm.


Por, çka po ndodh tani në Kosovë. Mendoni sikur të gjitha këto të kishin funksionuar, ndoshta atëherë nuk do të kishim qytetarë të Kosovës, të cilët çdo ditë e lëshojnë Kosovën për t'ia mësyre Evropës e bile bile nuk do të kishim edhe tragjedi të tilla. Skena politike e Kosovës, siç po shihet, më shumë preferon premtimet boshe dhe asfaltet e papërfunduara dhe jokualitative, sesa jetët e njerëzve. Kjo është ajo e cila po na vret dita e ditës. Kjo është ajo që po na mashtron që prapë të dalim t'i votojmë ata. Ka ardhur koha për ndryshim. Tani është koha që të rinjtë të marrin në dorë dijen bashkë me librat e tyre, t'i përvishen punës për krijimin e atij lideri që do t'i drejtojë deri te suksesi. ●



# Pse ende shqiptarët po ikin nga Kosova

**Thonë shpresa vdes e fundit, andaj edhe unë si bijë Kosove, një studente që planifikoj shumë për të ardhmen, shpresoj që do t'i arrij qëllimet e mia dhe do të punësohem në Kosovë e mos të detyrohem të emigroj në vendet e ndryshme të Evropës për një jetë më të mirë sikurse po bën populli im i përvuajtur, por kam shumë dëshirë të qëndroj pranë popullit tim dhe të jap çdo gjë nga vetja për këtë vend që ka shumë vlera**

**Valëza Gela**



Duke pas parasysh origjinën tonë të lashtë dhe atë duke filluar që nga Ilirët e tutje, kur populli shqiptar ishte një popull i cili përjetoi luftëra, okupime e pushtime të ndryshme, atëherë mund të themi lirisht se ky është një ndër faktorët kyç që ka ndikuar në gjendjen

e zhvillimit të ekonomisë dhe standardit të përgjithshëm në vendin tonë. Emigrimi i kosovarëve në vendet e ndryshme të botës nuk është në rënie, por ka tendenca të rritjes. Pra ne si popull kemi kaluar situata dhe kohë shumë të vështira. Janë disa faktorë që ndikojnë në emigrimin e shqiptarëve nga Kosova: varfëria e lartë, numri i madh i të papunëve, infrastruktura e dëmtuar etj. Varfëria është pika kyçe ajo që e detyroi shqiptarin, punëtor apo intelektual, të marrë rrugën e mërgimit, të ndjejë mundimin fizik e shpirtëror, të ndjejë mungesën e komunikimit me njerëzit e afërm dhe mungesën e atdheut, mungesën e gjuhës së nënës etj; vetëm për t'iu shmangur skamjes e varfërisë. Motivi i emigrimit është situata ekonomike në familjet kosovare dhe kjo mund të vështirësohet, nëse kushtet për rritje ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës nuk përmirësohen.

Emigrimi i popullsisë shqiptare për fat të keq ka vazhduar me shekuj dhe nuk ka të ndalur as ditët e sotme. Arsyet e emigrimit, sipas emigranteve, janë situata e rëndë ekonomike. Varfëria është një fenomen shumëdimensional me pasoja të dëmshme dhe të palakmueshme për individët të cilët gjenden në një situatë të tillë. Shumë familje janë të gatshme

edhe të paguajnë shuma të hollash për migrim jashtë vendit me shpresë për një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre. Ata edhe pse po paguajnë shuma parash njëkohësisht po rrezikojnë edhe jetën e tyre duke kaluar male të larta e të rrezikshme të vendeve evropiane me shpresë për të arritur në destinacionet e planifikuara.

Të ardhurat e ulëta në një familje të varfër ndikojnë drejtpërsëdrejti në emancipimin e familjes si p.sh. në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Rreth 50% e popullsisë në Kosovë ka një konsum në nivelin e varfërisë.

Vazhdimisht në Kosovë theksohet se do të krijohet infrastrukturë e nevojshme, vende të reja pune e shumë premtime tjera të mira për t'u dëgjuar mirëpo a po qëndrojnë ashtu në realitet për kosovarët? Në fakt jo... Kjo tregohet nga fakti që shumë familje në Kosovë qoftë shqiptare apo minoritete jetojnë nëpër kontejnerë që nuk i plotësojnë as kushtet minimale për jetesë, madje marrin edhe një ndihmë sociale shumë të vogël sa për të siguruar ushqim për fëmijët e tyre. Këto dukuri negative po i hasim çdo ditë duke parë fëmijë por edhe të rritur duke kërkuar lëmoshë nëpër rrugë të ndryshme të kryeqytetit mirëpo edhe mediat televizive dhe ato të shkruara po merren me këtë problem shumë serioz dhe shumë shqetësues për popullin kosovar i cili po përjeton kushte të vështira për jetesë.

Thonë shpresa vdes e fundit, andaj edhe unë si bijë Kosove, një studente që planifikoj shumë për të ardhmen, shpresoj që do t'i arrij qëllimet e mia dhe do të punësohem në Kosovë e mos të detyrohem të emigroj në vendet e ndryshme të Evropës për një jetë më të mirë sikurse po bën populli im i përvuajtur, por kam shumë dëshirë të qëndroj pranë popullit tim dhe të jap çdo gjë nga vetja për këtë vend që ka shumë vlera. ●